

GJYKATA E QARKUT NË PRISHTINË

P No. 570/07

Datë 27 maj 2009

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me një trup gjykues të përbërë nga:

- 1) Gjyqtari i EULEX-it, Z. Andrea CRUCIANI, si Kryetar i Trupit Gjykues,
- 2) Gjyqtari i EULEX-it, Z. Francesco FLORIT, si anëtar i panelit,
- 3) Gjyqtari Lokal, Z. Ferid BISLIMI, si anëtar i panelit,

të asistuar nga procesmbajtësja Jacqueline Ryan,

në lëndën penale kundër:

Bekim RASHITIT, i biri i Salihut dhe Fatimes (Vllasa), i lindur më 2 shkurt 1974 në Fshatin Peranë, Komuna e Podujevës, i pamartuar, Shqiptar, qytetar i Republikës së Kosovës;

Visar AHMETI, i biri i Avdiut dhe Nefisas (Bunjaku), i lindur më 8 maj 1979 në Fshatin Peranë, Komuna e Podujevës, ku banon, i pamartuar, Shqiptar, qytetar i Republikës së Kosovës;

Valon VLLASA, i biri i Isakut dhe Xhezides (Gervalla), i lindur më 20 gusht 1984 në Prishtinë, në rrugën Vellezerit Fazliu, ku banon, i pamartuar, Shqiptar, qytetar i Republikës së Kosovës;

V S (i mitur), i biri i Shahinit dhe Hamides (Gashi), i lindur më [REDAKTUAR] në [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], ku edhe banon, i pamartuar, Shqiptar, qytetar i Republikës së Kosovës;

Të gjithë të pandehurit të ngarkuar me veprën penale të **Rrëmbimit**, në **Bashkëveprim**, në kundërshtim me **Nenin 159, Paragrafi 2 dhe 23 i Kodit Penal të Kosovës (KPK)**, sepse më 10 dhjetor 2005, rreth orës 00:30, në Prishtinë, lagjja Dardania, të pandehurit, në bashkëveprim, të vetëdijshëm dhe sipas një marrëveshje paraprake, kanë rrëmbyer viktimën D Sh, duke e fshehur atë në shtëpinë e Shahin SFISHTËS në rrugën Fitorja në Podujevë, derisa e kanë liruar atë, më 13 dhjetor 2005 rreth orës 02:00, pasi që babai Gani SHALA ka paguar, në një rrugë të paasfaltuar afër fshatit Bradash, haraçin prej 230.000,00 EURO:

Pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit kryesorë në sesione të mbyllura më 1, 3, 27, 28, 29 prill 2009, 26 maj 2009, në praninë e të akuzuarit të përmendur më lartë, avokatëve mbrojtës dhe Prokurorit Publik Raze LOSHAJ;

pas shqyrtimit të trupit gjykues të mbajtur më 27 maj 2009;

në pajtim me Nenin 391 (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK);

ka shpallur publikisht dhe në praninë e të akuzuarit, avokatëve të tyre mbrojtës dhe Prokurorit Publik:

AKTGJYKIM

Se të akuzuarit janë shpallur

FAJTORË

Në lidhje me veprën penale të “rrëmbimit” në kundërshtim të Nenit 159 (2) të Kodit Penal të Kosovës (KPK) në Bashkëveprim sipas Nenit 23 të KPK-së;

DËNOHEN

Bekim RASHITI

Në përputhje me nenet 38, 159 (2) dhe 23 të KPK-së dënohet me burgim prej 5 vitesh;

Në përputhje me nenin 277 (4) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) anulohet dorëzania prej 30.000,00 EURO e vendosur për personin e dënuar.

Në përputhje me nenin 494 të KPPK-së, e njëjta shumë e parave prej 30.000,00 EURO konfiskohet dhe mbartet te palët e dëmtuara (D Sh dhe Gani SHALA) si kompensim i pjesshëm i dëmeve.

Visar AHMETI

Në përputhje me nenet 38, 159 (2) dhe 23 të KPK-së dënohet me burgim prej 3 vjetësh;

Valon VLLASA

Në përputhje me nenet 38, 159 (2) dhe 23 të KPK-së dënohet me burgim prej 4 vjetësh;

V S

Në përputhje me nenet 38, 48 (2) dhe (3), 159 (2) dhe 23 të KPK-së dhe nenit 6 (5) të Kodit për të Drejta të të Miturve të Kosovës dënohet me një dënim me kusht prej 2 vitesh të burgimit për të mitur.

Në përputhje me nenin 48 (2) të KPK-së, dënimi nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari nuk kryen një tjetër veprë penale brenda periudhës prej 5 vitesh nga data që aktgjykimi bëhet i formës së prerë.

Në përputhje me nenin 48 (3) të KPK-së, dënimi do të ekzekutohet nëse, brenda 1 viti nga data që aktgjykimi bëhet i formës së prerë, personi i dënuar nuk kompenzon palët e dëmtuara (D Sh dhe Gani SHALËN) me shumën prej EURO 200.000,00.

Për të gjithë të pandehurit, koha e kaluar në paraburgim përfshihet në madhësinë e dënimit që iu caktohet atyre.

KËRKESË PRONËSORE

I akuzuari, në total dhe së bashku, duhet të kompensoj palët e dëmtuara (D Sh dhe Gani SHALA) në shumë prej 230.000,00 EURO për dëmet e shkaktuara të cilat janë përcaktuar pas kërkesës.

SHPENZIMET

I akuzuari duhet të kompensoj shpenzimet e procedurës gjyqësore.

Pasi që mungojnë të dhënat mbi shumën e shpenzimeve, një vendim i veçantë do të merret mbi shumën e këtyre shpenzimeve.

ARSYETIM

HISTORIA PROCEDURALE

Më 31 tetor 2007, Prokurori Publik ka paraqitur aktakuzën ndaj të akuzuarve Bekim RASHITI, Arben SFISHTA, Visar AHMETI, Valon VLLASA, dhe propozimin për burgim për të miturin V S, të gjithë të akuzuar për veprën penale të rrëmbimit, në kundërshtim me nenin 159 (2) të KPK-së në bashkëveprim sipas nenit 23 të KPK-së. Më 7 prill 2008 dhe 14 prill 2008 Gjyqtari për Konfirmim ka lëshuar dy vendime duke vërtetuar aktakuzën për të akuzuarit e lartë përmendur.

Më 1 prill 2009, ka filluar shqyrtimi kryesor gjyqësor në seanca të mbyllura, pa prezencën e publikut, në përputhje me nenin 69 të Kodit të Drejtësisë së të Miturve të Kosovës. Të pranishëm ishin anëtarët e trupit gjykues siç specifikohet më lartë dhe të gjithë të pandehurit dhe avokatët e tyre mbrojtës. Të pranishëm po ashtu ishin palët e dëmtuara D Sh dhe Gani SHALA.

Kryetari i trupit gjykues e konfirmoj se trupi gjykues ishte formuar në përputhje me ligjin. Juridiksioni i Gjyqtarëve të EULEX-it në këtë rast bazohet mbi dispozitat e nenit 3 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Juridiksionin, Zgjedhjen e Rastit dhe Dhënien e Rastit Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it. Nuk ka pasur mospajtim nga ana e palëve për sa i takon përbërjes së Panelit.

Gjatë seancës së njëjtë, pas leximit të secilës pikë të aktakuzës nga Prokurori Publik, të pandehurit janë kërkuar të deklarohen fajtorë apo jo fajtorë. Të gjithë të akuzuarit u deklaruan të pafajshëm në të gjitha pikat.

Në lidhje çështjen, po ashtu të ngritur nga avokatët mbrojtës, që ka të bëjë me dështimin për të shpalosur të gjithë dokumentacionin nga Prokurori Publik, përjashtimi ishte kundërshtuar pasi që nuk ishte ngritur gjatë seancës së vërtetimit të aktakuzës dhe i bie që palët ishin të kënaqura me dokumentacionin e siguruar nga Prokurori Publik në atë kohë.

Më 3 prill 2009, dëshmitarët D Sh dhe Gani SHALA ishin marrë në pyetje.

Më 27 prill 2009, njëri nga të pandehurit, Arben SFISHTA, nuk ishte paraqitur në Gjykatë dhe avokati i tij mbrojtës kishte deklaruar se ai i ishte nënshtruar një intervenimi kirurgjik në sy në Norvegji dhe se do të kthehej në Kosovë për dy apo tre javë. Gjykata kishte konsideruar se as i pandehuri dhe as avokati i tij mbrojtës nuk kishin dorëzuar asnjë dokumentacion që mbështetë ekzistimin e një operacioni urgjent mjekësorë që do duhej të kryhej në Norvegji, kështu mungesa e Arben SFISHTËS nuk ishte arsyetuar. Prandaj, Gjykata lëshoi një vendim për arrestimin e të pandehurit të përmendur, në përputhje me nenin 270 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK). Gjykata po ashtu lëshoi, në përputhje me nenin 33 të KPPK-së, një vendim mbi ndarjen e procedurës, për sa i takon procedimit penal ndaj Arben SFISHTËS, ashtu që gjykimi aktual vazhdoi ndaj të pandehurve të tjerë, domethënë ndaj V S, Visar AHMETIT, Valon VLLASËS dhe Bekim RASHITIT.

Dëshmitari I V ishte ftuar si dëshmitarë në Gjykatë. Dëshmitari, babai i të pandehurit Valon VLLASA, zgjodhi të mos flasë, në përputhje me nenin 160, Paragrafi 1 (2), të KPPK-së.

Dëshmitari F A dhe I L ishin marrë në pyetje.

Deponimet e bëra nga Feim GAMIU në stacionin policor më 31 mars 2006 me pëlqimin e të gjitha palëve ishin dhënë si të lexuara dhe të bashkangjitura në dokumentacionin e lëndës.

Dëshmitari S R ishte ftuar si dëshmitarë në Gjykatë. Dëshmitari, i ati i të pandehurit Bekim RASHITI, zgjodhi të mos flasë, në përputhje me nenin 160, paragrafi 1 (2), i KPPK-së.

Më 28 prill 2009, dëshmitarja Sh A ishte thirrur si dëshmitarë në Gjykatë. Dëshmitarja, një familjare e afërt e të pandehurit Visar AHMETI, zgjodhi të mos flasë, në përputhje me nenin 160, paragrafi 1 (2), të KPPK-së.

Dëshmitari F K dhe N A ishin marrë në pyetje.

Gjykata pastaj kishte vazhduar me prezantimin e dëshmive materiale:

- Raporti i ADN-së numër 2006/0211, datë 29 qershor 2006, i lëshuar nga Instituti Forensik në Innsbruk, Austri;
- Opinioni i ekspertit mbi Analizat Forensike të ADN-së lab nr. 2006/0211, datë 30 qershor 2006;
- Për përgjimet telefonike të 2005/0119 të 5 prillit 2005;
- Raporti i siguruar nga PTK nga 10 dhjetori deri më 14 Dhjetor 2005 nga IMEI no. 351114106207180;
- Raporti për 8 dhjetorin 2005 deri më 12 dhjetor 2005 për numrin 044393739 dhe 044379774;
- Raporti mbi bisedat telefonike nga 12 dhjetori deri më 15 Dhjetor 2005 përmes kartelave me numër 044393739 dhe 044379774;
- Dokumentacioni kronologjik mbi evidencën numër 05-239, date 17 dhjetor 2005;
- Skica e vendit të incidentit ku viktima kishte qëndruar, 239 B, datë 27 dhjetor 2005;
- Përshkrimi dhe fotot e shtëpisë së Bekim Rashitit, Shahin Sfishtës dhe Visar Ahmetit, me numër 2005-0119, datë 21 dhjetor 2005;
- Raporti datë 21 prill 2006 i identifikimit të personave përmes një renditje të fotografive, gjatë së cilës viktima kishte identifikuar fotografitë nr. 1 dhe 8;
- Raporti datë 21 prill 2006 mbi identifikimin e vendit të krimit;
- Raporti i identifikimit të vendit të incidentit përmes fotografisë numër 005.04.2006;
- Kontrollimi i telefonit përmes laboratorit forensik numër 06-0211;
- Kontrollimi i Mercedesit me tabela të regjistrimit numër 128-KS-476 dhe foto dokumentacionin e taksisë;
- Lista numër 1543, datë 16 dhjetor 2005, mbi konfiskimin e artikujve të të pandehurit Arben Sfishta;
- Kuponi për blerjen e artikujve nga dyqani Albi Moni, datë 13 dhjetor 2005 me numër 1250, 1251 dhe 1254;
- Vërtetimi 1542 datë 16 dhjetor 2005 mbi konfiskimin e artikujve të Bekim Rashitit;
- Vërtetimi 2005/119, datë 16 dhjetor 2005, mbi konfiskimin e përkohshëm të artikujve të Visar Ahmetit, Salih Rashitit dhe Ismet Ahmeti;
- Vërtetimi numër 2005/01149, date 20 dhjetor 2005, mbi konfiskimin e përkohshëm të artikujve të Isak Villasës;
- Vërtetimi mbi konfiskimin e përkohshëm të artikujve të Bajram Sfishtës dhe Fatos Sfishtës;
- Raporti mjekësor numër 43617, datë 13 dhjetor 2005, mbi lëndimet e pësuar nga D Sh;

- Përshkrimi i fotove të automjeteve, datë 18 dhjetor 2005.

Pas kërkesës të avokatëve mbrojtës, Gjykata lexoj fjalë për fjalë në Gjykatë të gjithë urdhrat për regjistrimin dhe përgjimin e thirrjeve telefonike, si dhe për analizat e AND-së, duke gjetur se të gjitha aktivitetet e përmendura hetuese janë kryer në harmoni me urdhrat e Prokurorit Publik dhe Gjyqtarit të Procedurës Paraprake, kështu të gjitha rezultatet të aktiviteteve të matjes dhe përgjimit të telekomunikimeve dhe opinionet dhe raportet e ekspertit të AND-së, janë konsideruar si dëshmi të pranueshme.

Duke vendosur pas kërkesës së avokatëve mbrojtës në lidhje me pranueshmërinë e deponimeve të mëparshme në stacionin policor të dëshmitarit I V, Salih RASHITI dhe Sh A, gjykata vendosi se edhe pse ata ishin dëshmitarë të privilegjuar gjatë kohës së ekzaminimit, në përputhje me nenin 160, paragrafi 1 pika 2 të KPPK-së, ata nuk ishin informuar në lidhje me të drejtën e tyre për tu përjashtuar nga dhënia e dëshmisë, prandaj, deponimet e tyre janë konsideruar jo të pranueshme si dëshmi në këtë procedurë.

Avokati mbrojtës i të pandehurit Bekim RASHITI kishte dorëzuar disa foto të cilat u pranuan si dëshmi.

Të gjithë të pandehurit kishin vendosur të mos merreshin në pyetje dhe të mos flisnin.

Më 26 maj 2009, ishin prezantuar fjala përmbyllëse e Prokurorit Publik dhe të avokatëve mbrojtës të të gjithë të pandehurve. Gjykata u tërhoq për diskutim.

Më 27 maj 2009, pas diskutimit dhe votimit, Gjykata kishte shpallur dispozitivin e paraqitur në pjesën e mësipërme të këtij aktgjykimi.

KARAKTEERISTIKAT E RASTIT

1. Përgjegjësia penale e të gjithë të pandehurve për krimin e Rrëmbimit në Bashkëveprim, në kundërshtim me nenet 159, paragrafi 2 dhe 23 i KPK-së.

Pas ekzaminimit të dokumentacionit të lëndës, Gjykata ka gjetur se të gjithë të pandehurit janë fajtorë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm për veprën penale për të cilën ata janë ngarkuar në aktakuzat e vërtetuara të 7 prillit 2008 dhe 14 prillit 2008: Rrëmbim, në Bashkëveprim, në kundërshtim me nenet 159, paragrafi 2 dhe 23 i KPK-së sepse më 10 dhjetor 2005 rreth orës 00:30, në Prishtinë, Lagjen Dardania, të pandehurit, në bashkëveprim, qëllimisht dhe në bazë të një marrëveshjeje paraprake, kanë rrëmbyer viktimën D Sh, e kanë fshehur atë në shtëpinë e Shahin SFISHTËS në Rrugën Fitorja në Podujevë, deri sa e kanë liruar atë, më 13 dhjetor 2005 rreth orës 02:00, pasi që i ati Gani SHALA kishte paguar, në një rrugë të paasfaltuar afër fshatit Bradash, haraçin prej 230.000,00 EURO.

Përgjegjësia penale e të pandehurve buron nga të gjitha dëshmitë e grumbulluara në gjykimin kryesor, domethënë nga thirrjet e përgjuara telefonike, raportet e analizës së

AND-së, dëshmitë e palëve të dëmtuara (D Sh dhe Gani SHALA) dhe dëshmitë materiale të konfiskuara në apartamentet e të pandehurve.

Disa elemente të përgjithshme janë valide dhe të përbashkëta për të gjithë të pandehurit.

Nuk ka asnjë dyshim që më 10 dhjetor 2005, rreth orës 00:30, D Sh është rrëmbyer në Prishtinë, lagjen Dardania dhe se ai është mbajtur me forcë në shtëpinë e pabanuar të Shahin SFISHTËS, që gjendet në rrugën Fitorja në Podujevë, derisa të pandehurit e kanë liruar, më 13 dhjetor 2005, rreth orës 02:00, në lokacionin e fshatit Llukar, në lagjen “Arber”, afër rrugës kryesore Pristine-Llukar, pasi që i ati Gani SHALA ka paguar, afër fshatrave Bradash dhe Dobratin, në vendin “Lugu i Kacakeve”, haraçin prej 230.000,00 EURO.

Përshkrimi i ngjarjeve që kanë të bëjnë me rrëmbimin dhe pagesën e haraçit është ofruar në Gjykatë nga dëshmitë e dy personave të dëmtuar, D Sh dhe Gani SHALA.

Më poshtë është paraqitur një fragment nga procesverbali i marrjes në pyetje të dëshmitarit D Sh:

Prokurori Publik: Më 10 dhjetor 2005 rreth orës 00.45 ju ishit rrëmbyer.

D Sh: Po.

Prokurori Publik: Pyetja ime është, në ç’vend ju ishit rrëmbyer?

Kryetari i Trupit Gjykses: Do të kërkoja që ju ta shtronit pyetje në mënyrë tjetër.

Prokurori Publik: Ku ishit rrëmbyer?

D Sh: Në afërsi të shtëpisë sime e cila gjendet afër kopshtit të fëmijëve.

Prokurori Publik: Cila lagje?

D Sh: Dardania.

Prokurori Publik: Ku ishit duke shkuar në ato momente?

D Sh: Isha duke shkuar në shtëpi.

Prokurori Publik: Kënd keni takuar atë natë apo kush ju kishte takuar atë natë?

D Sh: Isha duke shkuar në shtëpi dhe pashë dy persona duke qëndruar më këmbë. Pastaj, ata ecën para meje. A dëshironi që unë të ju them të gjitha?

Prokurori Publik: Po.

D Sh: Ata më thanë se ishin nga policia. Ata më pyeten në lidhje me letërnjoftimin tim dhe unë u thash atyre se e kisha lënë atë në veturë sepse fillimisht e parkoj veturën time në hapësirën për parkim dhe pastaj shkoj në shtëpi. Ata mu afruan edhe më afër dhe pastaj unë i pyeta ata: “A mund të më tregoni ju lutem ID kartat tuaja sepse nuk e di nëse jeni nga policia?” Ata më thanë se nuk ishte nevoja për atë dhe mu afruan edhe më afër. Pastaj unë u përpoqa të largohem dhe shtyva njërin nga ata dhe ai që ishte para meje nxori armën e tij dhe me të vërtetë u çudita dhe i qova duart lartë ndërsa personi i cili ishte nga prapa meje mi vendosi duart prapa meje dhe mi vendosi prangat. Ai vendosi një mbulojë mbi kokën time dhe pastaj ata më detyruan të futesha në një veturë.

Prokurori Publik: Kur ju u futën në veturë, a kishit ende mbulojën në kokën tuaj?

D Sh: Po.

Prokurori Publik: Nëse të kujtohet, a mund të na e përshkruani veturën apo ngjyrën e saj.

D Sh: Mendova që ishte një veturë Mercedes, i zi. Ky ishte perceptimi im.

Prokurori Publik: Më thuaj, (Prokurori Publik u ndërpre)

Haxhi Millaku kundërshton ndaj përkthyesit që përdori shprehjen “perceptim” me që ai beson se shprehja ishte “mendoj”.

Haxhi Millaku: Dëshmitari tha: “Unë ‘mendoj’ se vetura kishte atë përshkrim”, derisa përkthyesi tha: “‘Perceptimi’ im ishte”. Shprehjet “mendoj” dhe “perceptim” janë dy fjalë të ndryshme. Ky ishte reagimi im të Nderuar Gjyqtarë dhe nëse interpretimi im është i saktë apo jo ju jeni këtu për ta vlerësuar.

Vërejtje: Fjalët në Shqip të cilave Avokati Mbrojtës i referohet janë: “mendoj” (“think” in English) dhe “perceptim” (“perception” in English).

Kryetari i Trupit Gjykses: E kuptojmë.

Prokurori Publik: Pyetja ime ishte, kur ata ju morën dhe ju futën në veturë, a kanë përdorur forcën ndaj jush?

D Sh: Ata vetëm nxorën armën kur unë e shtyva atë ndërsa ata më prangosen.

Prokurori Publik: A mund të ju rikujtohet udhëtimi edhe pse ju ende e kishit mbulojën në kokën tuaj?

D Sh: Gjatë udhëtimit unë isha në gjendje të vërej dritat e shtyllave në rrugë sepse kur ju udhëtoni me veturë këto drita ndërpriten shumë shpesh.

Prokurori Publik: A mundeni ju lutem të përshkruani këtë udhëtim dhe ku ishe duke udhëtuar kjo veturë?

D Sh: Pastaj ata u kthyen në të majtë dhe pastaj ata u kthyen në të djathtë, pastaj ata u kthyen prapë në të majtë. Pastaj u kthyen në të djathtë dhe pastaj dëgjova një zhurmë si një pengesë rrugore.

Prokurori Publik: Gjatë këtij udhëtimi, a flisnin mes vete personat që të kishin rrëmbyer?

D Sh: Së pari, kur ata më morën mua më pyetën se ku ishte vëllai im, Ilirjan është emri i tij dhe pastaj ata po ashtu më pyetën se ku isha duke i mbajtur drogën dhe më thane mua se do të më qonin mua në stacionin policor që të flasim më gjatë.

Prokurori Publik: Gjatë këtij udhëtimi, a flisnin këta persona mes veti apo me dike tjetër?

D Sh: Ne me siguri kemi udhëtuar për një orë e ca e pastaj vetura ishte ndalur, shoferi kishte dalë jashtë veturës, ai foli me dikë por unë nuk isha në gjendje të dëgjoj bisedën. Pastaj, u kthye në veturë dhe e futi veturën në pozitë për të shkuar prapa dhe derisa ishte duke shkuar prapa, vetura preku një gur dhe pasta ai shau në gjuhën Shqipe.

Prokurori Publik: Ata të dërguan te një shtëpi, a ishe në gjendje të shihje ndonjë gjë te porta e oborrit të kësaj shtëpie përkundër faktit që mbuloja ishte ende në kokën tuaj?

D Sh: A mund të ju pyes diçka? A mund të flas në lidhje me faktin kur unë u futa brenda apo kur u nxora jashtë?

Prokurori Publik: Vetëm kur je futur brenda.

D Sh: Para se ne të futeshim në shtëpi, unë eca në baltë dhe pastaj i ngjita tre shkallë, pastaj më kërkuan që të zbatheja këpucët dhe mbatha një palë papuçe.

Prokurori Publik: Kur ju kishit hyrë në shtëpi, ku ju dërguan ata?

D Sh: Në fillim ata më drejtuan në të djathtë dhe pastaj unë u ngjita në disa shkallë në formë të një rrethi, ata më ulën në një karrige, më bënë disa pyetje dhe pastaj më morën nga ai vend. Unë u dërgova në anën e majtë, pastaj, pasi që dola nga bodrumi, jam ngjitur disa shkallë për të shkuar lartë dhe pastaj u futa në një dhomë në anën e majtë.

Prokurori Publik: A mund të na e përshkruani dhomën në të cilën je vendosur?

D Sh: Së pari, kur jam futur brenda, nuk ka pasur llambë përveç një teli elektrik të varur nga tavani. Dera hapet nga brenda dhe ishte e drurit. Afër derës ishte një ndërprerës ndërsa ndërprerësi i llambës nuk ishte i vendosur, ju vetëm mund të shihnit telat. Pozita e llambës nuk ishte lartë në mur. (*Dëshmitari tregon një gjatësi prej 1 metri të lartë*). Tjegullat ishin të bardha me pak të hirtë. Muri nuk ishte plotësisht i bardhë por kishte gërvishje në të. Kjo është e tëra. Nuk kishte dritare në dhomë.

Prokurori Publik: A mund të ju kujtohet se sa e madhe ishte kjo dhomë?

D Sh: Afërsisht rreth 1.80 metër. Mund të jetë që nuk është gjerësia e saktë. Nuk isha në gjendje të shtrihem.

Prokurori Publik: A të kishin kontrolluar para se të kishin vendosur në atë dhomë?

D Sh: Po, ata më kishin kontrolluar dhe më kishin marrë çelësin e veturës sime Opel Astra të cilën e kisha me vete dhe pastaj më kishin pyetur: “Pse nuk ke para me vete?”

Prokurori Publik: Gjatë qëndrimit tuaj në atë dhomë, a kanë ardhur këta persona të shohin shpesh ?

D Sh: Ishte një person i cili më pyeti nëse doja të haja apo të pija diçka dhe në ditën tjetër, një person krejtësisht i ri erdhi dhe më pyeti nëse doja ndonjë gjë.

Prokurori Publik: A kishin ardhur me fytyra të mbuluara apo jo?

D Sh: Po, ata gjithmonë mbanin maska të zeza në fytyrat e tyre.

Prokurori Publik: A ishe në gjendje të identifikojë ndonjërin prej tyre bazuar në zërin e tyre përkundër faktit se ata mbanin këto maskat e zeza.

D Sh: Unë i kam identifikuar ata në stacionin e policisë dhe identifikova dy prej tyre bazuar në gojë dhe gisht.

Prokurori Publik: Këta janë personat që ju po thoni se ju kanë vizituar juve në dhomë.

D Sh: Po, personi që identifikova nga goja e tij ishte personi i cili kishte folur më së shumti me mua ndërsa personi të cilin e identifikova për shkak të gishtit, kishte ardhur vetëm një ditë. Të Hënën.

Prokurori Publik: Ju thoni se keni identifikuar atë për shkak të gishtit, si keni mundur ta bëni këtë?

D Sh: Kur kishin ardhur të më sillnin ushqimin, pashë se në dorën e majtë gishti i tij ishte i dëmtuar si të ishte i goditur nga një çekan. Por, mendoj se ishte kova që ata më mbanë për të urinuar dhe unë isha në gjendje të shoh gishtin e personit që mbante këtë kovë.

Prokurori Publik: Kur ata ishin future në dhomë, a kishit ju ende mbulojën në kokë apo jo?

D Sh: Jo.

Prokurori Publik: Çfarë lloji të ndihmës kishit kërkuar ju nga njerëzit të cilët kishin ardhur për të vizituar?

D Sh: Së pari, ata kishin sjellë një qese transportuese. Unë atëherë unë i kërkoja atyre që të më sillnin një shishe në mënyrë që të urinoja ndërsa ata më sollën këtë me vonesë dhe prandaj isha detyruar të urinoja në dhomë. Pastaj unë kërkoja nga ata cigare dhe po ashtu kërkoja nga ata të kontaktojnë familjen time përmes telefonit.

Prokurori Publik: A të kujtohet se nga kush keni kërkuar cigare apo kush ua ka sjellë cigaret dhe nëse ka diçka të veçantë që ju mund ta përshkruani?

D Sh: Personi i cili më vizitonte më së shpeshti dhe ky është personi që unë kam identifikuar nëpërmjet gojës, ai më solli cigaret dhe kujdesej më së shumti për mua.

Prokurori Publik: A të kujtohet se çfarë cigaresh ishin?

D Sh: West.

Prokurori Publik: A i ke pirë këto cigare?

D Sh: Po.

Prokurori Publik: Çfarë keni bërë me bishtin e cigares pasi që i ke pirë cigaret?

D Sh: Nuk kam pasur ndonjë mundësi tjetër veçse ti gjuaj në dysHEME.

Prokurori Publik: I ke pirë të gjitha?

D Sh: Po.

Prokurori Publik: Njerëzit të cilët janë futur në dhomën ku keni qëndruar ju, thatë se kanë pasur maska në kokat e tyre, a ishin ata duke mbajtur edhe dorëza?

D Sh: Vetëm personi që unë e identifikova përmes gojës ishte personi i vetëm që mbante dorëza ndërsa personi që unë e identifikova përmes gishtit të tij nuk ishte duke mbajtur dorëza.

Prokurori Publik: A të kanë ofruar këta njerëz që të informosh familjen tuaj në lidhje me vendndodhjen tuaj dhe në lidhje me atë se çfarë ishte duke të ndodhur?

D Sh: Po, ata u futën në dhomë. Ai ishte një person i gjatë. Kishte të veshur një jelek me shumë xhepa dhe ishte duke mbajtur një Kallashnikov dhe ai më dha një telefon në mënyrë që unë të flisja me familjen time. Pastaj, personi që unë identifikova përmes gojës së tij po ashtu më ofroi telefonin.

Prokurori Publik: A të kishin ofruar ata telefonin që kishin marrë nga ti apo të kishin ofruar ty një telefon të tyre?

D Sh: Së pari, ata më ofruan telefonin tim, një Samsung dhe pastaj unë përdora një Nokia një, por nuk mbaj mend modelet apo llojet por mund të gjejë ata në Internet apo nëse ka ndonjë fotografi, mund të tregoj se cilin kam përdorur.

Prokurori Publik: Kënd keni thirrur dhe çfarë i keni thënë familjes suaj?

D Sh: Së pari, i thash këtyre njerëzve kur më kishin dhënë telefonin tim se nuk kisha kredit. E ëma e të dashurës sime më thirri në telefon. Harrova ta përmendi më herët, së pari, kur isha futur atje, ata më kishin pyetur nëse doja të thërrisja shtëpinë dhe unë u kisha thënë se ishte pak vonë për t'i thirrur dhe se unë do të bëja këtë të nesërmen. Pastaj ata më kthyen telefonin dhe e ëma e të dashurës sime më thirri dhe unë i thashë asaj që t'i tregoj babait që të më thërriste. Pastaj unë fola me babin tim dhe i shpjegova atij ngjarjen dhe se çfarë kishte ndodhur.

Prokurori Publik: A i kishit thënë të atit tënd, se ishit rrëmbyer?

D Sh: I thash atij se isha mirë dhe se isha rrëmbyer.

Prokurori Publik: A kishte zgjatur biseda juaj gjatë apo shkurtë?

D Sh: Nuk isha bisedë e shkurtër por edhe e gjatë nuk ishte ndërsa unë isha në gjendje t'i shpjegoja atij paksa në lidhje me situatën.

Prokurori Publik: Gjatë qëndrimit tuaj në dhomë të kësaj shtëpie, a keni pyetur ndonjëherë njerëzit të cilët vinin të vizitonin në lidhje me vendin ku ishit duke u mbajtur?

D Sh: Kisha mundësinë të bisedoja me personin i cili unë e identifikova përmes gojës së tij dhe ai më tha se ata ishin në Pejë.

Prokurori Publik: Ai të tha se ishin në rajonin e Pejës?

D Sh: Po.

Prokurori Publik: A të thanë se kur e kishin ndër mend të të lironin?

D Sh: Unë e bëja këtë pyetje çdo ditë dhe përgjigjja e tyre ishte: “sa më parë që babai yt kompletonte gjithë këtë, aq më parë ti do të lirohesh.”

Prokurori Publik: Derisa ju qëndronit në dhomë, a kishte aty dritë?

D Sh: E vetmja dritë që futej në dhomë ishte ajo përmes fundit të derës.

Prokurori Publik: A ishit ju në gjendje të shihnit ndonjë gjë jashtë asaj dhome bazuar nga ajo dritë?

D Sh: Nuk isha në gjendje të shihja asgjë nga ajo dritë por njëherë kur ata hapën derën, pashë një arkë të sirtarëve anash derës.

Prokurori Publik: Para derës së dhomës suaj, a kishte aty shapka?

D Sh: Jo, por të gjithë ata kishin të mbathura shapka.

Prokurori Publik: Kur ju ishit futur në dhomë a kishit të mbathura këpucë apo jo?

D Sh: Hoqa këpucët dhe vendosa një palë shapka.

Prokurori Publik: Kur hoqe këpucët, a ishte akoma i prangosur?

D Sh: Isha i prangosur prapa shpine.

Prokurori Publik: Si është e mundur që ju kishit hequr këpucët?

D Sh: Përdora këmbët e mija që të zbatja këpucët sepse ata më thanë të zbatja këpucët.

Prokurori Publik: Nëse ne do të ofronim juve disa foto të shtëpisë ku ju keni qëndruar, a do ishit në gjendje të identifikoni vendin?

Mahmut Halimi: Në mënyrë që të kursejmë kohën, këto foto janë foto që tashmë janë paraqitur dhe janë marrë sipas përshkrimit të dëshmitarit.

Kryetari i Trupit Gjyqësor: Mendoj se propozimi i Prokurorit Publik është relevant.

Prokurori Publik: Ju keni origjinalet në dosje ndërsa unë kam kopjet.

Kryetari i Trupit Gjyqësor: Ne do të vazhdojmë me pyetjet derisa Zyrtari Ligjorë të kërkojë fotografite.

.....(pjesë e lënë).....

Prokurori Publik: A mund të përshkruani foton Nr. 1?

D Sh: Në foton Nr. 1, pasi që dola nga shtëpia, nuk di se si të përshkruaj, ishte një lloj i një gjëje të hekurt që unë e kisha prekur me dorën time sepse nuk isha i prangosur në atë moment dhe isha në gjendje të prek me duart e mija. Pastaj ata kishin hapur këtë dhe më kishin vendosur në veturë.

Prokurori Publik: Nëse të kujtohet, a mund të shpjegoni foton Nr. 3. A mund të dallosh ndonjë gjë? A është kjo gjëja që ju përmendët më herët?

D Sh: Këto janë ngjyrat e derës dhe tjegullat janë të njëjta me ato që ishin në dhomat ku unë isha duke u mbajtur. Nuk mund të përshkruaj këtë korridor pasi që kisha mbulojën në kokë.

Prokurori Publik: A mund të përshkruani ju lutem foton Nr. 6, domethënë shishen?

D Sh: Kjo është shishja nga e cila kisha pirë ujë dhe të cilën e kisha përdorur për të urinuar.

Prokurori Publik: Fotoja Nr. 13.

D Sh: Këto janë tjegullat ku unë kamë qëndruar dhe këto janë tjegullat në të cilat i kam fikur cigaret në dyshe.

Prokurori Publik: Fotoja Nr. 17.

D Sh: Kjo është pjesa sipër tavanit. Ajo paraqet telin e dalë jashtë prej tavanit dhe të gjitha muret e dhomës në anën time të djathtë ndërsa në anë e majtë kishte këto gërvishtje. Kjo është një foto, që paraqet tavanin.

Prokurori Publik: Nr. 26, a mundeni të lutem ta përshkruani këtë?

D Sh: Po, dera është e hapur. Kjo ishte dera dhe dorëza e derës ishte me ngjyrë të njëjtë siç është paraqitur në foto.

.....(pjesë e lënë).....

Prokurori Publik: Ditën para se të liroheshe, a ishin futur ata në dhomë?

D Sh: Po, ditën para se të lirohesha, më thanë se do të më lironin dhe më hoqën prangat pasi që im at kishte paguar paratë. Më vendosën një maskë në kokë dhe më përcollën jashtë.

Prokurori Publik: Pra, kur ju jeni përcjell jashtë dhomës, ju kishit prangat?

D Sh: Kur isha jashtë dhomës nuk kisha prangat.

Prokurori publik: A kishit maskën?

D Sh: Po.

Prokurori Publik: A dini se çfarë lloj i veturës ishte përdorur për të transportuar dhe se ku ishit dërguar?

D Sh: Nuk e kam ditur se çfarë lloji i veturës ishte pasi që kisha maskën por e di se koka ime mbështetej mbi një plastikë dhe brenda kishte një aromë vanilje. Dy apo tre ditë pas lirimit tim, unë kisha hyrë në një veturë të një shokut tim, një Golf 3 dhe kisha të njëjtën ndjenjë si dhe në veturën tjetër.

Prokurori Publik: Ku të kanë lënë?

D Sh: Kur më kanë lënë, nuk e kam ditur se ku isha pasi që ishte errësirë por unë kërkoja ndihmë. Xhaxhai im erdhi të më merrte dhe pastaj i thashë policisë se kisha hedhur maskën në atë lokacionin dhe pastaj kur shkova atje gjatë ditës e kuptova se cila rrugë kishte qenë.

Kryetari i Trupit Gjykoes: A ishte gjetur maska?

D Sh: Po.

Prokurori Publik: A të kujtohet, a kishit orë për të parë se çfarë kohe ishte?

D Sh: Ishte natë. Nuk e di por ndoshta ora 3 ose 4.

Prokurori Publik: Çfarë të kishin thënë ata kur ti ishe liruar?

D Sh: Ata më dhanë një telefon dhe unë e kuptova se ishte i vëllait tim. Ata më thanë se PIN kodi ishte 0000 por unë nuk mund të futja këtë PIN kod për të thirrur babin tim dhe pastaj më thanë të mos kthehesha për rreth 10 minuta derisa shkuan. Kisha një maskë por pak minuta më vonë, unë hoqa atë dhe kërkoja ndihmë.

Prokurori Publik: Ju thatë se ata ju dhanë telefonin e vëllait tuaj. Nga e kishin marrë? A thanë ndonjë gjë?

D Sh: Ata thanë se babai im u kishte dhënë atyre këtë telefon.

Gjykata e konsideron D Sh një dëshmitarë plotësisht të besueshëm, duke marrë parasysh se tregimi i tij është i qëndrueshëm në brendësi, bindës dhe shumë i pasur me detaje. Fakti i ditur se ai njëkohësisht është edhe viktimë, nuk ndikon në besueshmërinë e tij, që bazohet në elementët e përmendur. Më e rëndësishmja është se të gjitha rrethanave që iu referohet dëshmitari vërtetohen nga dëshmitë tjera të pranishme në dokumentacionin e lëndës. Pjesa më e rëndësishme e dëshmisë në këtë aspekt është opinionin e ekspertit mbi analizën forensike të ADN-së të lëshuara nga laboratorin e ADN-së në Innsbruck (Austria), datë 30 qershor 2006, pas urdhërësive nga Gjyqtari i Procedurës Paraprake për analizë nga eksperti, të datave 3 shkurt 2006, 14 shkurt 2006, 15 shkurt 2006, 15 shkurt 2006 dhe 27 shkurt 2006. Opinioni i ekspertit të përmendur në mënyrë të pakundërshtueshme dëshmon se mostrat e urinës të gjetura në shtëpinë e pabanuar të Shahin SFISHTËS kanë nxjerrë profilet e D Sh. Në veçanti, rezultati përfundimtar i analizës së ekspertit të përmendur citohet nëpërmjet kësaj: “Analiza e ADN-së e mostrës së mundshme të urinës, mostra CS # 1.3, paraqiti një profil të mashkullit i cili është i njëjtë me profilin e D Sh. Në aspektin bio-statistikor nuk ekziston asnjë dyshim i arsyeshëm që D Sh është burimi biologjik i profilit të gjetur në mostrën CS # 1.3.”

Viktima D Sh po ashtu ka njohur në Gjykatë vendin ku ai është kidnapuar (fotot numër 3, 13, 17 dhe 26) dhe shishen në të cilën ka urinuar (fotoja numër 6). Fotot e bashkangjitura ndaj raportit forensik të Departamentit Forensik - MHQ Pristina – i cili është përpiluar më 17 dhjetor 2005.

Po ashtu i ati i viktimës, Gani SHALA, i cili kishte paguar haraçin prej 230.000,00 EURO ka dëshmuar në Gjykatë.

Këto janë fragmentet e rëndësishme nga procesverbali i dëshmisë së tij:

Prokurori Publik: Ju jeni këtu si dëshmitarë dhe ju po ashtu jeni babai i viktimës. Disa pyetje të shkurtra do të ju bëhen sot në lidhje me atë se çfarë të kishte ndodhur ty dhe djalit tënd. Pyetja është a të kujtohet kur ishte kidnapuar djali juaj?

Gani Shala: Mund të ketë qenë e Premte apo e Shtune nuk më kujtohet por tashmë kam dhënë një deklaratë. Nuk më kujtohet për momentin nëse kishte qenë e Premte apo e Shtune pasi që kam fshirë këtë nga mendja ime.

Prokurori Publik: Kur e keni kuptuar se djali juaj ishte rrëmbyer apo kush të kishte treguar?

Gani Shala: Unë isha në punë në Miradi. E dashura e djalit tim më thirri dhe në atë moment, unë formova numrin e Denisit. Denisi u përgjigj në telefon dhe më tha se e kishin rrëmbyer.

Prokurori Publik: Pasi që djali juaj ju informoj se ishte rrëmbyer çfarë hapash ndërmoret?

Gani Shala: E lash punën dhe shkova në shtëpi. I thash gruas sime dhe dy djemve të tjerë që Denisin e kishin rrëmbyer.

Prokurori Publik: A të kujtohet nëse Denisi të kishte thirrur shpesh në telefon?

Gani Shala: Jo. Kisha edhe një telefonatë tjetër nga ai por jo në atë kohë por më vonë.

Prokurori Publik: A e keni raportuar rastin në polici apo jo?

Gani Shala: Po.

Prokurori Publik: Çfarë ndodhi pastaj, a të ka thirrur dikush më vonë?

Gani Shala: Gjatë raportimit të rastit për policinë në stacionin policorë Nr. 2, kur i thashë atyre se djali im ishte rrëmbyer, unë mora një thirrje tjetër telefonike.

Prokurori Publik: A të kujtohet se kush iu kishte thirrur?

Gani Shala: Rrëmbyesit më kishin thirrur.

Prokurori Publik: A të kishin thirrur duke përdorur numrin e Denisit apo ndo një tjetër?

Gani Shala: Nuk më kujtohet.

Prokurori Publik: Ju po thoni se rrëmbyesi të kishte thirrur; a të kujtohet se çfarë të tha?

Gani Shala: Herën e parë, kur më kishin thirrur kishin kërkuar €500,000 në këmbim të lirim të djalit tim ndërsa herën e dytë, më thanë që nuk guxojta të raportoja rastin në polici dhe se nëse do bëja këtë, ata do më vrisnin djalin.

Prokurori Publik: A të kishin thirrur prapë kështu shpesh apo kishte një periudhë ndërprerjeje në mes të këtyre telefonatave?

Gani Shala: Me sa më kujtohet, ata nuk kanë thirrur atë natë, por nuk jam i sigurt.

Prokurori Publik: A keni provuar të thirrni numrin e telefonit të birit tuaj ?

Gani Shala: Po. Çdo herë që kisha provuar, numri ishte i fikur.

Prokurori Publik: A të kujtohet ndonjëri nga numrat e tjerë të cilët ishin të regjistruar në thirrjet që të ishin bërë ty përveç numrit të telefonit të birit tuaj?

Gani Shala: Me sa më kujtohet, ishte një numër Nr. 101 apo 010 por ka kaluar një kohë e gjatë që atëherë dhe nuk më kujtohet.

Prokurori Publik: A të ishin kërcënuar përmes telefonit që ju duhet të grumbulloni paratë sa më shpejt që është e mundur.

Gani Shala: Po.

Prokurori Publik: Çfarë të thanë ata nëse të kujtohet?

Gani Shala: Më kujtohet që më kishin thënë të grumbulloja paratë sa më parë që është e mundur dhe t'i dorëzoja ato. U kisha thënë atyre se nuk kisha atë shumë parash dhe se nuk kishte ndonjë mënyrë që unë të grumbulloja atë sasi të hollash pa i shitur veturat, shtëpinë dhe tokën përveç nëse do huazoja të hollat nga shokët sepse shuma ishte mjaft një shumë e madhe. Nuk ishte aspak e mundur që unë të gjeja shumën prej 500,000€. Më kujtohet që ishte e Shtunë kur më kishin thirrur. U thashë atyre se nuk mund të gjeja gjithë këtë shumë të të hollave sepse bankat nuk janë të hapura dhe që të presim deri të Hënë dhe të shohim nëse mund të mbledhë këto të holla apo jo.

Prokurori publik: A të kishin dhënë një afat në lidhje me atë se kur do duheshe t'i dorëzoje të hollat te ta?

Gani Shala: Biseda kryesore ishte mbajtur të Hënë dhe qëllimi i kërkesës së tyre ishte që unë të dorëzoja paratë sa më shpejtë që është e mundur. Të Hënë unë mblodha paratë nga miqtë e mi dhe arrita të grumbulloj €160,000 dhe kur ata më thirrën por nuk më kujtohet koha, unë u thash atyre që kisha arritur të gjeja €165,000 apo €185,000. Nuk më kujtohet shuma e saktë pasi miqtë më ndihmonin mua të grumbulloja ato. Ishte pasdite kur unë mora thirrjen tjetër dhe kur ata thirrën ne u pajtuam për 230,000€ dhe ata po ashtu më thanë se kjo ishte thirrja e tyre e fundit për mua dhe se do duhesha të gjeja këtë shumë të cilën arrita ta gjej të cilën sigurisht se e huazova nga miqtë e mi. Tanimë e kamë thënë në deklaratën time se ku i kisha marr paratë dhe emrat e të gjithë miqve ku i kisha marr ato.

Prokurori Publik: Ju thatë se ata kishin kërkuar një shumë mjaft të madhe të të hollave, €500,000. Si është e mundur që ju ja dolët të pajtoheshit për një shumë më të vogël prej €230,000? A kishit vështirësi të pajtoheshit për këtë shumë të re?

Gani Shala: U thashë atyre se kurrfarë mundësie që unë të mblidhja atë shumë parash edhe nëse do vrisnin djalin tim. Çdo herë që më thërrisnin, u thosha se nuk mund të përmbushja shumën fillestare të kërkuar të të hollave që ata kërkonin.

Prokurori Publik: Pasi që ju u pajtuat për shumën tjetër e cila ishte €230,000, çfarë ndodhi pas arritjes së kësaj marrëveshjeje? Cilat ishin instruksionet e dhëna nga ata për ju?

Gani Shala: Kur ata më thirrën para mbrëmjes dhe më pyetën nëse kisha arritur të mblidhja këtë shumë dhe përgjigjja ime ishte po dhe se kisha grumbulluar €230,000, u thashë atyre se isha gati që të dërgoja të hollat në një vend që ata do të zgjidhnin. Rrëmbyesit më thanë të prisja udhëzime të tjera. A dëshironi të bëjë në deklaratë plotë apo do të dëshironit që të iu përgjigjem pyetjeve që më bëhen mua? Sa herë më kanë thirrur, etj.

Prokurori Publik: A do të ishte më e lehtë për ty që të vazhdonit pa pyetje apo me pyetje? Cilat ishin udhëzimet e tyre për sa i takon dorëzimit të të hollave?

Gani Shala: Unë është dashur të shkoja me BMW-ne time por në momentin e fundit ata kërkuan nga unë të merrja veturën e Denisit dhe isha udhëzuar të mos merrja askënd me vete. Askush nuk duhej të më përcillte dhe isha udhëzuar të merrja pasaportën time me mua.

Prokurori Publik: A të kishin thënë rrëmbyesit që të merrje vetëm veturën e Denisit?

Gani Shala: Vetura e tij ishte përmendur por nuk jam i sigurt sepse ka kaluar një kohë e gjatë. E di që vetura e Denisit ishte përmendur. Mendoj se modeli ishte përmendur, Opel Vectra. Opel Corsa ishte vetura ime. Unë do duhesha të shkoja dhe të dorëzoja paratë në BMW dhe pastaj ata më thanë që të mos përdorja atë por të merrja veturën e Denisit. Tash nuk më kujtohet nëse fjala "Opel" ishte përdorur nga ata.

Prokurori Publik: A të kujtohet kur kishe dalë nga shtëpia me qëllim që të shkoje dhe dorëzoje të hollat, a ishte natë apo ditë?

Gani Shala: Ishte mjaft vonë por nuk më kujtohet saktësisht koha. Ishte pas orës 20.00.

Prokurori Publik: A mundeni ju lutem të na e përshkruani udhëtimin nga shtëpia juaj për në vendin ku do duheshit të dërgonit paratë?

Gani Shala: Në thirrjen e fundit që unë kisha ata më thanë të merrja pasaportën time dhe të shkoja në drejtim të Mitrovicës dhe kur arrita në qytetin e Mitrovicës, më kishin thënë që të prisja instruksione tjera dhe kur isha futur në qytet, morra një thirrje tjetër nga rrëmbyesit dhe ata më thanë të merrja rrugën Shala Bajgora dhe të vozisja deri në fund të rrugës së asfaltuar dhe unë fillova të vozisja në atë rrugë dhe u ngjita përpjetës. Ishte natë. Nuk shihja askënd dhe pa pyetur askënd, fillova të vozisja në rrugë të paasfaltuar. Vazhdova të vozis në rrugë të paasfaltuar duke shpresuar që do të shihja ata sepse isha i frikësuar se të tjerë persona mund të vinin në vendin e përcaktuar. Vozita përmes një fshati dhe pashë xhaminë në atë fshat dhe pastaj vozita deri arrita prapë në rrugë të asfaltuar dhe më kujtohet se rruga ishte në mes të Kerpimehit. Kur arrita rrugën e asfaltuar, mora një thirrje telefonike nga rrëmbyesit dhe isha pyetur se ku isha dhe unë i thashë atyre se isha në rrugë të asfaltuar dhe më pyetën se pse nuk prita lartë dhe kërkuan nga unë që të kthehesha prapa duke përdorur të njëjtën rrugë. Unë mora rrugën e gabuar. Shkova me një oborr dhe në atë rrugë, një person, dikush, ishte atje dhe unë e pyeta sepse ishte natë, për rrugën për në Bajgorë dhe ai më tha se rruga ishte menjëherë pas shtëpisë së tij dhe kur shkova te ajo rrugë, atë që kisha shfrytëzuar më herët, kalova afër xhamisë dhe pastaj disa kilometra më tutje, se di saktësisht, rruga ishte me baltë. Kishte shumë kthesa dhe në kthesën e dytë më ndaluan dy persona dhe më thanë të fikja motorin dhe të dilja nga vetura. Unë fika motorin. Njëri nga këta persona ishte në anën time të djathtë ndërsa tjetri lëvizi derisa mbërriti dritat e pasme të veturës. Ky person më kontrollon fizikisht. Kisha dy telefon me vete. Njëri ishte numri im personal ndërsa tjetri ishte i djalit tim Ilirjanit. Rrëmbyesit më pyetën për të hollat dhe unë u thashë atyre se ishin në kitin për dorëza të makinës. Të hollat ishin në një qese shumë të vogël të letrave të tualetit dhe personi që mbante maskë dhe që mbarte një armë automatike mori paratë derisa personi i cili ishte më afër meje, ai më tha kur numëruam paratë, ne do të lirojmë birin tuaj. Ata më thanë se do ta lironin atë diku në drejtim të Klinës në Pejë. Unë u futa në veturë por nuk mund të vozisja në përpjetë dhe njëri prej tyre i cili qëndronte afër meje, ai u mundua po ashtu të shtynte veturën sepse kishte tepër baltë. Unë nuk munda ta nisi veturën dhe u thashë atyre se do duhesha të shkoja prapa duke përdorur rrugën e njëjtë të paasfaltuar nga Podujeva për në Prishtinë. Në atë moment e ktheva veturën dhe u nisa në drejtim të shtëpisë sime.

.....(pjesë e lënë).....

Nike Lumezi: Kam pyetje të shkurtra. I nderuari Gjyqtar, a ishin policia e informuar në lidhje me vendimin e tij për të shkruar në vendin e përmendur për të bërë këmbimin?

Gani Shala: Ata ishin të informuar dhe ishin duke aplikuar vegla për përgjim.

Nike Lumezi: A ka kërkuar dëshmitari nga policia që ata të instalojnë në veturën e tij ndonjë pajisje për përcjellje?

Gani Shala: Unë mbaja pajisje përgjimi ndërsa pajisje të tjera ishin instaluar në BMW-në time por në momentin e fundit kur pyeta nëse do duhej të shkoja me BMW-në time, ata më thanë se unë do duhej të shkoja atje me Opel Vecter. Në këtë automjet nuk kishte pajisje. Pasi që policia nuk kishte njohuri për këtë, pasi që kalova kthesën e parë për të shkuar lartë në Shalë të Bajgorës, unë e hodha xhaketën time që kishte pajisjet që e kisha të veshur sepse e dija që rrëmbyesit do të më kontrollonin fizikisht dhe unë e ndjeva, për hire të fëmijës tim, nuk doja që më e keqja të ndodhte sepse sipas thirrjeve kërcënuese, nëse do i tregoja policisë ata do më vrisnin djalin.

.....(pjesë e lënë).....

Kryetari i Trupit Gjykses: Kur u kontrollove nga dy persona të cilët të ndaluan gjatë dorëzimit të haraçit, a kanë marrë ndonjë gjë nga ju përveç të hollave?

Gani Shala: Jo, ata morën telefonin e djalit tim dhe thanë se ky telefon do t'ij jepet djalit tim kur të lirohet dhe se djali im do të më thërriste duke përdorur telefonin që ata morën nga unë.

.....(pjesë e lënë).....

Po ashtu Gani SHALA do të konsiderohet një dëshmitarë plotësisht i besueshëm, duke marrë parasysh se tregimi i tij është i qëndrueshëm në brendësi, bindës dhe shumë i pasur me detaje. Për më tepër, të gjitha veprimet e Gani SHALËS janë monitoruar nga policia, nga momenti i raportimit të incidentit. Telefoni i tij është përgjuar dhe të hollat janë grumbulluar në praninë e policisë.

Përshkrimi i ngjarjeve të paraqitura nga dëshmitarët D Sh dhe Gani SHALA për më tepër është vërtetuar përmes thirrjes telefonike të pranuar në numrin e telefonit të Gani SHALËS nga djali i tij më 12 dhjetor 2005, në ora 18:42, vetëm disa orë para pagesës së haraçit:

D Sh: Alo;

Gani SHALA: Alo D si je?

D Sh: Jam shumë mira baba, mos u brengos edhe pak edhe do te nisem;

Gani SHALA: Në rregull a je larg?

D Sh: Jo nuk jam nisur ende por tani do të nisem;

Gani SHALA: Në rregull;

D Sh: Në rregull, mos brengos askënd sepse unë jam shumë mirë;

Gani SHALA: Në rregull, mirupafshim;

D Sh: Mirupafshim.

Është thelbësore të ceket edhe një herë që menjëherë pasi që Gani SHALA ishte kontaktuar për herë të parë nga rrëmbyesit, ai e kishte raportuar incidentin në polici. Hetuesit kishin reaguar menjëherë dhe pas urdhrave të përkohshëm të Prokurorit Publik dhe urdhrave pasues të gjyqtarit të procedurës paraprake, telefoni i tij me numër 044120210) dhe numri i telefonit të gruas së tij (044610005) ishin përgjuar. Përmes kësaj ishte gjetur se thirrjet ishin bërë nga telefonat mobil të identifikuar nga IMEI numrat 351114106207180, që i përket Bekim RASHITIT dhe 350985102955720, që i përket Arben SFISHTËS. Këta telefona më vonë ishin përgjuar dhe rezultatet e përgjimeve të cekura pa asnjë dyshim demonstrojnë përfshirjen e të pandehurit në aktivitetet penale për të cilat ata janë ngarkuar. Hetuesit po ashtu kishin vazhduar me aktivitetet e tjera hetuese, siç janë bastisja e shtëpive të Shahin SFISHTËS (ku D Sh ishte mbajtur) dhe të të pandehurve; vëzhgimi gjatë natës i grumbullimit të shumës së haraçit dhe analiza e ADN-së në lidhje me gjurmët e gjetura në shtëpinë e Shahin SFISHTËS.

2. Përgjegjësia penale e Bekim RASHITIT.

I pandehuri Bekim RASHITI, së bashku me të pandehurin tjetër në arrati Arben SFISHTA, bartë përgjegjësinë më të madhe në rrëmbimin e D Sh. Ai ka qenë personi që ka organizuar rrëmbimin dhe ka udhëhequr aktivitetet kriminale që nga fillimi deri në mbarim.

Përgjegjësia e tij penale buron nga një gamë e gjerë e dëshmive të pakundërshtueshme.

Para së gjithash dhe më e rëndësishmja, rezultatet e përgjimeve telefonike do të merren në konsideratë. Pas urdhërave të përkohshëm të Prokurorit Publik dhe urdhërave pasues të gjyqëtarit të procedurës paraprake, numri i telefonit i Gani SHALËS (044120210) dhe numri i telefonit i gruas së tij (044610005) janë përgjuar. Duke e bërë këtë, është gjetur se thirrjet janë bërë nga telefonat mobil të identifikuar përmes IMEI numrave 351114106207180, që i përkiste Bekim RASHITIT (shif dokumentacionin kronologjik të 15 dhjetorit 2005) dhe 350985102955720, që i përkiste Arben SFISHTËS. Në veçanti, SIM kartela që bartë numrin 063752650 është përdorur në telefonin Nokia 7210, me ngjyrë të hirtë dhe të kaltër, të identifikuar përmes IMEI numrit 351114106207180, për të kontaktuar Gani SHALËN gjatë datave kritike. Mbuloja e numrit të SIM kartelës 063752650 më vonë është gjetur në apartamentin e Bekim RASHITIT, pas një bastisje të shtëpisë më 16 dhjetor 2005 (urdhri për bastisje i Gjyqtarit të Procedurës Paraprake, SEK 187/05 të 15 dhjetorit 2005). Thirrjet telefonike në mes të Bekim RASHITIT (IMEI 351114106207180) dhe Gani SHALËS (044120210), janë vet-shpjeguese. Ato ishin bërë në datën e pagesës të haraçit, pikërisht më 12 dhjetor 2005 në 21:13, 21:17, 21:23, 22:07, 22:21, 22:29. Gjatë këtyre bisedave telefonike Bekim RASHITI i jepte udhëzime të detajuara Gani SHALËS në lidhje me atë se si të shkonte në vendin ku haraçi do të duhej të paguhej. Kur Gani SHALA kishte arritur në vendin e pagesës, Bekim RASHITI përfundimisht i kishte urdhëruar atij të dilte jashtë veturës dhe të vazhdonte të ecte më kë për të sjellë paratë.

Më poshtë është biseda telefonike në mes të Bekim RASHITIT dhe Gani SHALËS e 12 dhjetorit 2005 në ora 22:29:

Bekim RASHITI: Alo;

Gani SHALA: Alo, jam unë Ganiu, këtu është përpjeta dhe unë e dëmtova veturën dhe nuk po mund të ngjitem, Do të provoj edhe një herë. Mund të vonohem pesë minuta për shkak të baltës dhe e kam dëmtuar derën;

Bekim RASHITI: Dëgjo;

Gani SHALA: Po;

Bekim RASHITI: Ti nuk mund të vish këtu me veturë, lije veturën, merr paratë dhe hajde lartë;

Gani SHALA: Në rregull, Do të provoj edhe një herë;

Bekim RASHITI: Merr paratë me vete dhe hajde lartë.

Thirrje të tjera vendimtare janë ato në mes të Bekim RASHITIT dhe të pandehurve të tjerë. Ne veçanti, një thirrje telefonike kryesore është ajo në mes të Bekim RASHITIT dhe Valon VLLASËS më 12 dhjetor 2005 në ora 17:47. Gjatë asaj thirrje të pandehurit ishin qartë shumë të kujdesshëm të mos përdorin emra dhe përmendur aktivitetet kriminale në të cilat ishin të përfshirë. Ata diskutuan dhe u ankuan në lidhje me Arben

SFISHTËN, i cili kishte vepruar pa një konsultim të mëparshëm me ta dhe i cili kishte vendosur të përfshinte në rrëmbim edhe të vëllanë, V S dhe persona të tjerë të ndryshëm nga grupi fillestar, i cili ishte i përbërë nga Bekim RASHITI, Valon VLLASA dhe Arben SFISHTA. Bekim RASHITI po ashtu e risiguroj Valon VLLASËN që edhe nëse haraçi nuk do të paguhej i pari do t'i jepte këtij të dytit ca para:

Bekim RASHITI: çka ka të re;

Valon VLLASA: qe, çka ka të re;

Bekim RASHITI: Nuk munda ti takoja ata, tash jam rrugës;

Valon VLLASA: Aaaa;

Bekim RASHITI: Hej njeri edhe nëse nuk bëhet asgjë, unë do të jap ty ca, mos u brengos;

Valon VLLASA: jo dajë por po ndjehem keq për ty futja atyre, po t'ja qi nanen e tij majmunesh, ai është një majmun i shkërdhym;

Bekim RASHITI: mos u brengos;

Valon VLLASA: nuk ja vlen, nëse disa gjëra do të ishin në vendet e tyre, do ti jepja atij pa problem;

Bekim RASHITI: jo ai ka kërkuar vetëm një bojaxhi, edhe një tjetër dhe ai tha ashtu a po me kupton, unë nuk kam dashur të përzihem me të a po me kupton, thash ma mire është te nisemi njeri, për atë e ka ai, për atë të them ty qija bre nanen;

Valon VLLASA: që ngë fillimi ai kishte filluar t'i përzinte gjërat, dhe tash luan bole, kjo nuk është në rregull;

Bekim RASHITI: në rregull, të thash, të thash diçka;

Valon VLLASA: ti i thuaj atij që, thuaj atij, dhe thuaj atij që ajo është pak, ti i thuaj atij që dhe mos të vjen turp;

Bekim RASHITI: në rregull, në rregull mos u brengos, do të dëgjohemi;

Valon VLLASA: Do t'i them atij po ashtu kur ta shof;

Bekim RASHITI: në rregull;

Valon VLLASA: në rregull atëherë;

Bekim RASHITI: s'ka gjë, qija nanen, për gjëra të vogla pse;

Valon VLLASA: o jo Bekë por jam i zemëruar dajë, qija nanen, ai vëllai atje, budalla, pa folur me askënd kinse unë jam duke bërë diçka, po e bëjë këtë e atë;

Bekim RASHITI: për atë nuk kam dashur të marr ndonjë bojaxhi, për atë nuk kam dashur;

Valon VLLASA: ai pas, pasi që vetëm unë dhe ti dhe ai ishim, tash ai merr 6 apo 7 kinse po bëjë diçka;

Bekim RASHITI: hej, do te takohemi;

Valon VLLASA: në rregull;

Gjithashtu bisedat telefonike në mes të Bekim RASHITIT, Valon VLLASËS dhe Visar AHMETIT në të cilat i pari kërkon nga dy bashkautorët tjerë të kthehen dhe ta marrin pasi që haraçi ishte siguruar, janë shumë të qarta. Transkripti i plotë i atyre bisedave raportohet në brendësi më vonë në këtë aktgjykim kur të analizohet roli i Visar AHMETIT.

Një pjesë tjetër e rëndësishme e dëshmisë është maska e zezë e cila është gjetur në apartamentin e Bekim RASHITIT, pas një bastisje të shtëpisë së tij. Raporti i policisë është përpiluar më 18 dhjetor 2008, ndërsa bastisja e shtëpisë u bë më 15 dhjetor 2005 në ora 22:45. Policia gjeti maskën e zezë që autori kishte përdorur gjatë rrëmbimit, copat e materialit që ka rezultuar pas prerjes së syve të maskës së përmendur dhe mbulesa e mbulojës së SIM kartelës së Tel Mob që mbarte numrin 063-7452650. Nga raporti i përmendur: “Dhoma e fjetjes është ndodhej në anën jug-perëndimore të korridorit dhe kishte një dollap rrobash, një shtrat për fjetje dhe po ashtu një komodinë me pasqyrë, në dollapin e rrobave në pjesën ku varehin rrobat ishte maska e punuar nga një kapelë prej leshit me ngjyrë të zezë dhe në njërin nga kostumet e varura ishte kartela rimbushësh e

telefoni mobil dhe një kapelë e leshtë me ngjyrë të zezë ishte në shtrat afër jastëkut, ndërsa në shportën e mbeturinave në banjo kishte një copë të leshtë, e cila mendohet të jetë copë e maskës.” Fotot e maskës së zezë (fotot 12-16), të copave të materialit të prerë të maskës (fotot 21-24) dhe mbulesa e SIM kartelës së Tel Mob që kishte numrin 063-7452650 (fotot 19-20) i janë bashkangjitur raportit policorë të përmendur më lartë.

Për më tepër, më 12 dhjetor 2005, në ora 23:18, një taksi i bardhë MERCEDES, me tabelë të regjistrimit 128-KS-476, pronë e Isak VLLASËS, babai i Valon VLLASËS, ishte parë nga Ekipi i Vëzhgimit i Drejtorisë së Krimit të Organizuar (DKO) duke hyrë në rrugën për në fshatin Dobratin, e cila është rruga ku të hollat ishin këmbyer, me një shpejtësi të madhe. Më vonë gjatë natës së njëjtë, më 13 dhjetor 2005, në ora 00:31, Ekipi i Vëzhgimit kishte parë një AUDI të gjelbër, me numër regjistrimi 146-KS-345, të Bekim RASHITIT, që ishte ndalë pranë MERCEDES-it të lartë-përmendur dhe një person duke dal nga AUDI-ja dhe që i ishte afruar MERCEDES-it. Duhet shtuar se policët (raporti i 27 dhjetorit 2005, me numër reference 2005-0119), më 16 dhjetor 2005, në ora 18:30, derisa ishin duke e vizituar shtëpinë e Salih RASHITIT, babait të Bekim RASHITIT, kishin vërejtur që i parkuar në oborr të shtëpisë ishin, në mes tjerash, edhe AUDI-ja e gjelbërt, me numër të tabelave 146-KS-345 dhe taksi i bardhë MERCEDES, me numër të tabelave 128-KS-476.

3. Përgjegjësia penale e Visar AHMETIT.

I pandehuri Visar AHMETI ishte personi që kishte pasur pjesën më të vogël të përgjegjësisë në rrëmbim. Megjithatë, kontributi i tij po ashtu ishte thelbësor në aktivitetin kriminal, pasi që ai ka marrë Bekim RASHITIN nga vendi ku ishte mbledhur haraçi dhe ai po ashtu kishte mbajtur kontakte me një person të panjohur i cili kishte huazuar armët e përdorura gjatë aktiviteteve kriminale.

Përgjegjësia penale e Visar AHMETIT buron thirrjet telefonike të përgjuara në mes të atij (044142332) dhe të bashkë-pandehurve Bekim RASHITI dhe Valon VLLASA. Në veçanti, në bisedën telefonike të 12 dhjetorit 2005, në ora 23:11, Bekim RASHITI kkishte kërkuar nga Visar AHMETI, i cili ishte bashkë me Valon VLLASËN, që të shkonin dhe ta merrnin, pasi që haraçi ishte paguar:

Bekim RASHITI: Alo;

Visar AHMETI: Çfarë po bën?

Bekim RASHITI: Qe, e ti?

Visar AHMETI: Çka ka të re;

Bekim RASHITI: Gjallë;

Visar AHMETI: A je i zënë?

Bekim RASHITI: Jo, jam bashkë me axhën, duke bërë rreth;

Visar AHMETI: A mund të vish dhe të më marrësh; Nuk jam larg nga rruga;

Bekim RASHITI: Çka?

Visar AHMETI: A mund të vish të më marrësh?

Bekim RASHITI: Ku është kjo rreth;

Visar AHMETI: Po;

Bekim RASHITI: Në rregull, ne po vijmë andej;

Visar AHMETI: Në rregull, nuk jam larg vetëm ejani kënde.

Dhjetë minuta më vonë, në ora 23:23, Bekim RASHITI kishte thirrur Valon VLLASËN dhe ata ia dolën ta takojnë njëri tjetrin:

Bekim RASHITI: A kaluat?
Valon VLLASA: Alo;
Bekim RASHITI: A kaluat?
Valon VLLASA: Po, po;
Bekim RASHITI: Kthehu, kthehu poshtë;
Valon VLLASA: Ah, tani.

Një thirrje tjetër e rëndësishme është ajo në mes të Arben SFISHTËS dhe Visar AHMETIT e bërë më 13 dhjetor 2005, në ora 19:31, ditën pas pagesës së haraçit. Njëra nga armët e përdorura gjatë rrëmbimit dhe marrjes së haraçit disi kishte humbur dhe personi prej të cilit ata e kishin huazuar bënte presion mbi Arben SFISHTËN që ta kthente atë. Arben SFISHTA dhe Visar AHMETI në thirrjen telefonike të përmendur po mundoheshin të gjenin një zgjidhje dhe ata po planifikonin të blinin një tjetër armë për të zëvendësuar atë që ata kishin huazuar:

Arben SFISHTA: Çfarë të bëjmë me të nëse nuk mund ta gjejë, çfarë të bëjë, çka të bëj njeri;
Visar AHMETI: Dërgoja atë që e kishte;
Arben SFISHTA: A është në rregull;
Visar AHMETI: Po, dërgoja atë që kishte, apo pyete atë ose ne do të gjejmë një zgjidhje më vonë;
Arben SFISHTA: Po pyes njeri, do ta pyes, nëse mund ta gjesht kërkoje, nëse nuk mund ta gjesht vetëm më thirr dhe unë do të sjell ty paratë dhe;
Visar AHMETI: Aha;
...(pjesë e lënë)...
Arben SFISHTA: dhe dajë do ta kërkoj sonte prapë nëse mundem, do ta dërgoj atë prapë dhe të marrë një tjetër;
Visar AHMETI: Jo mos shko sot ta marrësh, thuaj atij njeri mbaje këtë mos rri pa asgjë dhe thuaj atij le të gjejmë një zgjidhje por thuaj se po kërkojmë diçka më mirë;
...(pjesë e lënë)...
Visar AHMETI: Për ta blerë atë, shiko nëse do mund të gjesht ti e din për çka të thashë këtë;
Arben SFISHTA: Po, tetë ha;
Visar AHMETI: Pesëmbëdhjetë;

Në bisedën telefonike të 15 dhjetorit 2005, në ora 20:37, të dy këta kishin thirrur njëri tjetrin edhe një herë dhe Arben SFISHTA e kishte informuar Visar AHMETIN që ai kishte vizituar personin nga i cili kishin huazuar armët:

Arben SFISHTA: Isha te ai dajë;
Visar AHMETI: Po;
Arben SFISHTA: kështu unë ...si ishte;
Visar AHMETI: Po, po;
Arben SFISHTA: I dërgova atij një si atë, ai tha kështu e ashtu, tha ku është Visari, unë i thashë ai është nervozuar, ai tha thuaj Visarit që nuk mund të rri dhe a mund të blej ushqim këtu dhe aty;

Gjithashtu, duhet të theksohet se Visar AHMETI dhe Bekim RASHITI kanë qenë në kontakt disa herë gjatë datave dhe kohës kritike. Në veçanti, nga regjistrimi i thirrjeve telefonike rezulton se më 10 dhjetor 2005, Bekim RASHITI kishte kontaktuar dy herë Visar AHMETIN, në ora 01:19 dhe 01:20 – vetëm pesëdhjetë minuta pas rrëmbimit të D

Sh. Po ashtu, më 12 dhjetor 2005, ditën që ishte paguar haraçi, Bekim RASHITI kishte kontaktuar katër herë Visar AHMETIN në ora 13:27, 17:53, 20:28 dhe 23:16. Për më tepër, nga 28 nëntori 2005 deri më 15 dhjetor 2005, Visar AHMETI dhe Arben SFISHTA kishin kontaktuar njëri tjetrin me 11 thirrje dhe kishin 36 përpjekje për thirrje. Tash, tanimë është demonstruar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm që Bekim RASHITI ka luajtur rolin e organizatorit kryesor, së bashku me Arben SFISHTËN, në rrëmbim dhe në atë që më 12 dhjetor 2005 ai pa dyshim se ishte i përfshirë në grumbullimin e haraçit. Kështu nuk do të ishte e arsyeshme dhe jo reale që Bekim RASHITI, i cili në atë kohë ishte i përfshirë në një aktivitet të rrezikshëm kriminal, do të bënte dhe pranonte disa thirrje nga Visar AHMETI gjatë kohës kritike të incidentit nëse nuk do të ishte për diçka që ka të bëjë me rrëmbimin. Është e rëndësishme që ata nuk kanë bërë asnjë referencë të hollësishme për asnjë arsye tjetër për thirrjet e përmendura, siç është për shembull për tu takuar për ndonjë pije në bar apo ngjashëm por ata ishin gjithmonë shumë të kujdesshëm të mos përmendin arsyet se pse duhej të takoheshin aq me urgjencë atë natë. Gjithashtu duhet të vërehet që i pandehuri Visar AHMETI, si dhe të gjithë të pandehurit e tjerë, nuk kishte propozuar asnjë shpjegim alternativ të mundshëm për thirrjet e përmendura telefonike, pasi që kishte vendosur të mos flasë në Gjykatë.

4. Përgjegjësia penale e Valon VLLASËS.

Edhe kundër të pandehurit Valon VLLASËS burimet kryesore të dëshmisë janë thirrjet e përgjuara telefonike në mes të atij dhe bashkë-pandehurve Bekim RASHITI dhe Arben SFISHTA. Në veçanti, nga 12 dhjetori 2005 deri më 15 dhjetori 2005, Valon VLLASA (044393739) kishte dy biseda me Arben SFISHTËN dhe trembëdhjetë biseda me Bekim RASHITIN.

Është me vlerë për raportin e integruar edhe një herë biseda telefonike në mes të Bekim RASHITIT dhe Valon VLLASËS më 12 dhjetor 2005 në ora 17:47. Gjatë asaj thirrje të pandehurit qartazi ishin shumë të kujdesshëm të mos përdornin emra dhe të përmendnin aktivitetet kriminale në të cilat ata ishin të përfshirë. Ata biseduan dhe u ankuan për Arben SFISHTËN i cili ka vepruar pa konsultim paraprak me ata dhe i cili kishte veëndosur të përfshijë në rrëmbim edhe të vëllanë e tij, V S dhe personat e tjerë të tjerë nga grupi fillestar, i cili përbëhej nga Bekim RASHITI, Valon VLLASA dhe Arben SFISHTA. Bekim RASHITI njashtu e kishte ri-siguruar Valon VLLASËN që edhe nëse haraçi nuk do të paguhej, i pari do ti kishte dhënë të dytit ca të holla:

Bekim RASHITI: çka ka të re;

Valon VLLASA: qe, çka ka të re;

Bekim RASHITI: Nuk munda ti takoja ata, tash jam rrugës;

Valon VLLASA: Aaaa;

Bekim RASHITI: Hej njeri edhe nëse nuk bëhet asgjë, unë do të jap ty ca, mos u brengos;

Valon VLLASA: jo dajë por po ndjehem keq për ty futjau atyre, po t'ja qi nanen e tij majmunesh, ai është një majmun i shkërdhym;

Bekim RASHITI: mos u brengos;

Valon VLLASA: nuk ja vlen, nëse disa gjëra do të ishin në vendet e tyre, do ti jepja atij pa problem;

Bekim RASHITI: jo ai ka kërkuar vetëm një bojaxhi, edhe një tjetër dhe ai tha ashtu a po me kupton, unë nuk kam dashur të përzihem me të a po me kupton, thash ma mire është te nisemi njeri, për atë e ka ai, për atë të them ty qija bre nanen;

Valon VLLASA: që nga fillimi ai kishte filluar t'i përzinte gjërat, dhe tash luan bole, kjo nuk është në rregull;
Bekim RASHITI: në rregull, të thash, të thash diçka;
Valon VLLASA: ti i thuaj atij që, thuaj atij, dhe thuaj atij që ajo është pak, ti i thuaj atij që dhe mos të vjen turp;
Bekim RASHITI: në rregull, në rregull mos u brengos, do të dëgjohemi;
Valon VLLASA: Do t'i them atij po ashtu kur ta shoh;
Bekim RASHITI: në rregull;
Valon VLLASA: në rregull atëherë;
Bekim RASHITI: s'ka gjë, qija nanen, për gjëra të vogla pse;
Valon VLLASA: o jo Bekë por jam i zemëruar dajë, qija nanen, ai vllau atje, budalla, pa folur me askënd kinse unë jam duke bërë diçka, po ee bëjë këtë e atë;
Bekim RASHITI: për atë nuk kam dashur të marr ndonjë bojaxhi, për atë nuk kam dashur;
Valon VLLASA: ai pas, pasi që vetëm unë dhe ti dhe ai ishim, tash ai merr 6 apo 7 kinse po bëjë diçka;
Bekim RASHITI: hej, do te takohemi;
Valon VLLASA: në rregull;

Në bisedën telefonike tashmë të përmendur të datës 12 dhjetor 2005, ora 23:11, Bekim RASHITI kishte kërkuar nga Visar AHMETI, i cili ishte bashkë me Valon VLLASËN, të shkonin dhe ta merrnin, pasi që haraçi ishte paguar:

Bekim RASHITI: Alo;
Visar AHMETI: Çfarë po bën?
Bekim RASHITI: Qe, e ti?
Visar AHMETI: Çka ka të re;
Bekim RASHITI: Gjallë;
Visar AHMETI: A je i zënë?
Bekim RASHITI: Jo, jam bashkë me axhën, duke bërë rreth;
Visar AHMETI: A mund të vish dhe të më marrësh; Nuk jam larg nga rruga;
Bekim RASHITI: Çka?
Visar AHMETI: A mund të vish të më marrësh?
Bekim RASHITI: Ku është kjo rreth;
Visar AHMETI: Po;
Bekim RASHITI: Në rregull, ne po vijmë andej;
Visar AHMETI: Në rregull, nuk jam larg vetëm ejani këndeje.

Dhjetë minuta më vonë, në ora 23:23, Bekim RASHITI kishte thirrur Valon VLLASËN dhe ata ia dolën ta takojnë njëri tjetrin:

Bekim RASHITI: A kaluat?
Valon VLLASA: Alo;
Bekim RASHITI: A kaluat?
Valon VLLASA: Po, po;
Bekim RASHITI: Kthehu, kthehu poshtë;
Valon VLLASA: Ah, tani.

Një bisedë tjetër vendimtare ishte bërë më 12 dhjetor 2005, në ora 21:34, në mes të Valon VLLASËS dhe Bekim RASHITIT. Valon VLLASA i cili ishte duke përcjell lëvizjet e Gani SHALËS iu drejtua Bekim RASHITIT se Gani SHALA ishte vetëm. Ata qartazi përdornin një gjuhë të koduar, në të cilën Gani SHALA quhet "vajzë":

Valon VLLASA: E pashë atë vajzë, ajo ish vetëm, nuk fola aspak me të, vetëm e pashë atje.

Për më shumë, një pjesë e madhe e peshës së dëshmimeve duhet t'i atribuohet rezultateve të aktiviteteve të vëzhgimit. Siç është përmendur tashmë, më 12 dhjetor 2005, në ora 23:18, një taksi i bardhë MERCEDES, me tabelë të regjistrimit 128-KS-476, pronë e Isak VLLASËS, babai i Valon VLLASËS, ishte parë nga Ekipi i Vëzhgimit i Drejtorisë së Krimit të Organizuar (DKO) duke hyrë në rrugën për në fshatin Dobratin, e cila është rruga ku të hollat ishin këmbyer, me një shpejtësi të madhe. Më vonë gjatë natës së njëjtë, më 13 dhjetor 2005, në ora 00:31, Ekipi i Vëzhgimit kishte parë një AUDI të gjelbër, me numër regjistrimi 146-KS-345, të Bekim RASHITIT, që ishte ndalë pranë MERCEDES-it të lartë-përmendur dhe një person duke dal nga AUDI-ja dhe që i ishte afruar MERCEDES-it. Duhet shtuar se policët (raporti i 27 dhjetorit 2005, me numër reference 2005-0119), më 16 dhjetor 2005, në ora 18:30, derisa ishin duke e vizituar shtëpinë e Salih RASHITIT, babait të Bekim RASHITIT, kishin vërejtur që i parkuar në oborr të shtëpisë ishin, në mes tjerash, edhe AUDI-ja e gjelbër, me numër të tabelave 146-KS-345 dhe taksi i bardhë MERCEDES, me numër të tabelave 128-KS-476.

Dëshmitarët, të cilët, pas kërkesës të avokatit mbrojtës, janë marrë në pyetje në gjykatë, nuk mundën të demonstrojnë ndonjë alibi të vlefshëm për të pandehurin.

Posaçërisht, dëshmitari F K, i cili është pronar i një palestere sporti, ku Valon VLLASA po ashtu rregullisht bën ushtrime, ishte në gjendje vetëm të theksojë se Valon VLLASA me gjasë ka trajnuar edhe më 12 dhjetor 2005, prej orës përparësisht 18:00 deri në ora 20:00. Kjo rrethanë nuk përbënë ndonjë alibi për të pandehurin. Thirrjet e përgjuara telefonike të lartpërmendura në mes të tij dhe bashkë-pandehurit Bekim RASHITI ishin bërë para (17:47) apo pas (23:11, tutje) sesionit të trajnimit në palestër. Kështu, Valon VLLASA ka mundur që së pari të bëjë ushtrimet në palestër dhe më vonë të përfshihet në rrëmbim, duke e marrë me veturë Bekim RASHITIN pas pagesës së haraçit.

Më poshtë është paraqitur një fragment nga procesverbali i marrjes në pyetje të dëshmitarit F K:

.....(pjesë e lënë).....

Haxhi Millaku: A mund të na thoni kur kishte ardhur Valon Vllasa të ushtroj te ju, ditën, kohën?

F K: Po. Valoni ushtronte për një kohë mjaft të gjatë dhe gjatë trajnimit në kalonim mirë dhe në ushtrimet së bashku. Zakonisht fillonte në ora 6 m.d. e tutje, kjo nuk ishte gjithmonë kështu por zakonisht ishte kështu sepse ai ushtrimi që ne bënim; ne na nevojitej një partnerë, dhe kështu ne ishim po ashtu partner.

Haxhi Millaku: Për këtë lloj të ushtrimeve, që ju keni bërë së bashku, sa gjatë e keni bërë këtë?

F K: Ishte 2 orë apo 2 e gjysmë.

.....(pjesë e lënë).....

Haxhi Millaku: A e din më 12/12/2005 kur kishte ardhur Valoni në palestër?

Kryetari i Trupit Gjykoës: Do të riformuloj këtë pyetje sepse veç nënkupton përgjigjen. A kishte ardhur Z. Valon Vllasa në palestër më 12 dhjetor 2005?

F K: Nuk më kujtohen datat por ai kishte në qejf këtë dhe vinte çdo ditë sepse e kishte marrë këtë shumë seriozisht.

Kryetari i Trupit Gjykoës: Kështu në periudhën e muajit dhjetor 2005 ai vinte çdo ditë?

F K: Po sepse dhjetori për ne ishte një muaj shumë i zënë, e kam fjalën për ushtrime.

Po ashtu, dëshmitari N A, i cili është pronari i një internet kafeje, kishte thënë në Gjykatë që Valon VLLASA me shumë gjasë ka qenë në dyqanin e tij më 12 dhjetor 2005,

rreth orës 21:00 dhe për ca kohë. Dëshmitari kishte thënë se Valon VLLASA kishte qëndruar atje ndoshta 3 ose 4 orë por ai nuk ishte i sigurt në lidhje me kohëzgjatjen e saktë të qëndrimit të tij (“Nuk e di, ndoshta 3-4 orë”). Gjykata beson se ai kishte qëndruar në internet kafe më pak se 3 apo 4 orë, ndoshta 1 ose 2 orë, pasi që thirrjet e përgjuara telefonike në mënyrë të pakundërshtueshme dëshmojnë përfshirjen e të pandehurit në aktivitetet kriminale duke filluar përafërsisht nga ora 23:00. Kështu, edhe një herë, edhe dëshmia e tij nuk përbënë ndonjë alibi për të pandehurin. Thirrjet e përgjuara telefonike në mes të tij dhe bashkë-pandehurit Bekim RASHITI ishin bërë më vonë në mbrëmje duke filluar nga ora 23:11 e më tej. Kështu, Valon VLLASA ka mundur shumë lehtë të ndjek ushtrimet nga përafërsisht ora 18:00 deri përafërsisht në ora 20:30, pastaj internet kafënë nga ora përafërsisht 21:00 deri sa ishte përfshirë në aktivitetet kriminale, rreth orës 23:00, duke e marrë me veturë Bekim RASHITIN pas pagesës së haraçit.

Në anën tjetër, dëshmia e N AT kishte rezultuar të paraqes një element tjetër të rëndësishëm kundër të pandehurit. Në të vërtetë, N A kishte thënë se në mbrëmjen e 12 dhjetorit 2005 i pandehuri nuk sillej si zakonisht, pasi që nuk ishte i përqendruar në lojërat dhe dilte dhe hynte në kafe. Kjo sjellje e pazakontë e Valon VLLASËS duhet të vlerësohet në dritë të ngjarjeve. Gjatë mbrëmjes së njëjtë, Valon VLLASA ishte i përfshirë në rrëmbim sepse ai duhej të shkonte të merrte Bekim RASHITIN pasi që të paguhej haraçi. Kjo është arsyeja pse ai ishte nervoz dhe kishte mendime të tjera në mendjen e tij e jo lojën e Counter Strike.

Më poshtë janë fragmente të rëndësishme nga marrja në pyetje e dëshmitarit N AT:

Haxhi Millaku: A vinte Valoni në internet kafen tuaj?

N A: Po.

Haxhi Millaku: A vinte rregullisht?

N A: Nuk mund të them se ai ishte një klient i rregullte por ai vinte atje.

Haxhi Millaku: Cili ishte orari i punës i kësaj internet kafeje?

N A: Ndonjëherë hapej rreth orës 9 dhe ne punonim deri në ora 2-3 p.d. të ditës tjetër, varësisht nga ajo se sa klientë kishim.

Haxhi Millaku: A të kujtohet në çfarë ore të ditës Valon Vllasa vinte në internet kafen tuaj?

N A: Ai zakonisht vinte kur luanin Counter Strike.

Kryetari i Trupit Gjykses: Counter Strike?

N A: Është një video lojë. Të rinjtë mblidhen së bashku për të luajtur këtë lojë.

Haxhi Millaku: Afërsisht në çfarë kohe vinte ai në internet kafen tuaj për të luajtur këtë lojë?

N A: Loja serioze fillon kur bëhet natë.

Haxhi Millaku: A e din se në çfarë kohe bëhet natë në dhjetor?

N A: 4.30 apo 5 lojërat më e mira luhen në mbrëmje.

.....(pjesë e lënë).....

Haxhi Millaku: Më 12/12/2005, a ishte Valon Vllasa në internet kafen tuaj?

N A: Kur bë fillim ata erdhën për të marrë deklaratën time, personi i cili më pyeste mua quhej Derk dhe kjo ishte një kohë e shkurtër pas asaj çfarëdo që ndodhi kështu që unë munda ta kujtoj këtë në mënyrë të qartë. Ndonjëherë unë punoja në mbrëmje dhe ndonjëherë punonte vëllai im. E di shumë mirë që ajo ditë ishte e Hënë sepse vëllai im kishte punuar javën e mëparshme dhe unë kisha filluar të Hënë. Të të them të vërtetën, nuk do të më kujtohej kjo por tani unë u ndjeva i obliguar të dija këtë sepse e di se çfarë do të thotë të japësh një deklaratë të saktë apo të pasaktë. Unë jam njeri familjar.

Haxhi Millaku: A është ajo çfarë i thatë hetuesit e saktë, a të kujtohet deri në çfarë kohe Valon Vllasa kishte qëndruar në internet kafen tuaj?

N A: Nuk e di se sa gjatë kishte qëndruar, e di që internet kafeneja ishte e mbushur; Mendoj se nuk e di saktësisht, ai erdhi rreth orës 9. Ai luante në kompjuterin numër 9 i cili ishte përballë meje dhe nganjëherë ai dilte jashtë dhe pastaj kthehej dhe unë bëra shaka me të dhe i thashë ose luaj ose shko.

Haxhi Millaku: Sa gjatë qëndroi që kur i shiç thatë ju, erdhi në ora 9?

N A: Nuk e di, ndoshta 3-4 orë. Më kujtohet se ai hynte dhe dilte nga kafeneja, ju duhet të përqendroheshi për të luajtur Counter Strike ndërsa ai nuk bënte këtë.

.....(pjesë e lënë)....

Francesco Florit: Në deklaratën tuaj të mëparshme ju keni përshkruar sjelljen e të akuzuarit, Z. Valon Vllasa, në një mënyrë të veçantë duke thënë se ai sillej në mënyrë të çuditshme dhe se ishte nervoz, çfarë mund të na thoni për këtë?

N A: Ju thash se ai dilte nga kafeneja dhe prapë futej brenda. Ai nuk shkaktonte problem por nuk ishte sjellja e tij e zakonshme, kjo është pse unë isha i bezdisur. Zakonisht ai vjen në dyqan, merr një pije dhe nuk flet por atë ditë ai erdhi dhe futej brenda dhe dilte jashtë shpesh, kjo është çfarë në një far mënyre më bezdiste.

5. Përgjegjësia penale e V S.

Nuk mund të ngritët kurrfarë dyshimi në lidhje me përgjegjësisë penale të të pandehurit V S. Në të vërtetë, numri dhe madhësia e dëshmive kundër tij është e madhe.

Në rend të parë, ekziston opinioni i ekspertit mbi analizat forensike të ADN-së të nxjerra nga laboratorit i ADN-së në Innsbruck (Austri), datë 30 qershor 2006, pas urdhrave për analizë të ekspertit nga Gjyqtari i Procedurës Paraprake të datës 3 shkurt 2006, 14 shkurt 2006, 15 shkurt 2006, 15 shkurt 2006 dhe 27 shkurt 2006. Opinioni i përmendur i ekspertit në mënyrë të pakundërshtueshme dëshmon që kapela që është gjetur nga hetuesit paraqiste profile të përziera të V S dhe D Sh. Në veçanti rezultati përfundimtar i analizës së përmendur të ekspertit citohet nëpërmjet kësaj: “Analizat e ADN-së të kapelës #13 dhanë një profil të përzier. Përzierja paraqet profilet e Denisë SHALËS dhe V S. Sipas statistikës biologjike nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm që viktima D Sh dhe i dyshuari V S i kishin kontribuar kësaj përzierje.” Kjo vetëm mund të nënkuptoj që e njëjta kapelë ishte përdorur nga që të dy këta. Nuk mund të jepet asnjë shpjegim tjetër i mundshëm në lidhje me këtë rrethanë përveç se kapela e V S është vendos në kokën e viktimës D Sh për të mbuluar fytyrën e tij gjatë rrëmbimit të tij. Është rasti për të përmendur se i pandehuri vendosi të mos flasë, duke mos i ofruar kështu Gjykatës asnjë shpjegim tjetër të mundshëm apo të besueshëm në lidhje me këtë rrethanë të dalë.

Në vendin e dytë, viktima D Sh kishte thënë se njëri nga kryerësit e veprës kishte thoin e zi në gishtin e madh të dorës së majtë.

Më poshtë vijon një fragment nga procesverbali i marrjes në pyetje të D Sh:

Prokurori Publik: A ishe në gjendje të identifikojë ndonjërin prej tyre në bazë të zërit përkundër faktit se ata mbanin këto maskat e zeza.

D Sh: Unë kam identifikuar ata në stacionin e policisë dhe identifikova dy prej tyre bazuar në gojën dhe gisht.

Prokurori Publik: Këta janë personat që ju po thoni se ju kanë vizituar juve në dhomë.

D Sh: Po, personi që identifikova nga goja e tij ishte personi i cili kishte folur më së shumti me mua ndërsa personi të cilin e identifikova për shkak të gishtit, kishte ardhur vetëm një ditë. Të Hënën.

Prokurori Publik: Ju thoni se keni identifikuar atë për shkak të gishtit, si keni mundur ta bëni këtë?

D Sh: Kur kishin ardhur të më sillnin ushqimin, pashë se në dorën e majtë gishti i tij ishte i dëmtuar si të ishte i goditur nga një çekan. Por, mendoj se ishte kova që ata më mbanë për të urinuar dhe unë isha në gjendje të shoh gishtin e personit që mbante këtë kovë.

Prokurori Publik: Kur ata ishin future në dhomë, a kishit ju ende mbulojën në kokë apo jo?

D Sh: Jo

.....(pjesë e lënë).....

D Sh: Isha në stacionin policorë dhe ata më treguan vetëm një foto të gishtit dhe më pyetën nëse ky ishte gishti që kisha parë dhe unë u përgjigja po.

Vahide Braja: Si mund të thuash se është gishti i njëjtë?

D Sh: Gishti i madh i dorës së majtë kishte të njëjtat lëndime si dhe në foto dhe për këtë arsye unë e identifikova gishtin.

Vahide Braja: Ju thatë se ishte një dhomë e errët dhe se mund të shihje dritën vetëm nga fundi i derës, pra si munde të identifikojë lëndimin?

D Sh: Kërkova një kovë qoftë për të urinuar në të apo për të vjell dhe kur e sollën atë, ishte ditë dhe kur dera u hap isha në gjendje për të parë.

Në të vërtetë, kur policia intervistoj V S më 2 janar 2006 ai akoma e kishte thuan e zi në gishtin e madh të dorës së tij të majtë dhe kjo është vërtetuar si nga fotot e të pandehurit me thoin e zi të bëra nga policia që gjenden në dosjen ee lëndës ashtu nga deklaratat e të pandehurit para Prokurorit Publik, në prani të avokatit të tij mbrojtës, më 28 maj 2008:

Prokurori Publik: A e ke pas atë kohë gishtin tënd të madh të majtë të lënduar apo të ndrydhur?

I pandehuri: Po, e kam lënduar derisa isha duke punuar.

Prokurori Publik: A mban mend ta kesh pasur që nga 10.12.2005 gishtin tënd të madh të mavijosur?

I pandehuri: Po dhe e kam lënduar duke punuar.

Krejt në fund, ekziston biseda telefonike shumë e qartë dhe e rëndësishme e datës 12 dhjetor 2005, në ora 14:21, në mes të Arben SFISHTËS dhe të dashurës së tij të atëhershme Sh A (Buqe) e cila ishte përgjuar dhe në të cilën Arben SFISHTA i thotë të dashurës së tij që V S do t 'i sillte asaj ca para pasi që të paguhej haraçi:

Arben SFISHTA: Visar do ju sjell juve pak para më vonë dhe ai do t 'i lë ato në banesë;

Sh A: Cili Visar;

Arben SFISHTA: Visari, vëllai im;

Sh A: Pse?

Arben SFISHTA: për shkak të ata ai do të sjell atje ca para dhe do të lë paratë, unë do të shkoj atje dhe ai do t 'i sjell.

6. Elementi material (*actus rei*) dhe elementi psikologjik (*mens rea*) dhe kualifikimi ligjorë.

Të gjitha pjesët e përmendura të dëshmimeve dhe rrethanave dëshmojnë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm përfshirjen e të pandehurve në rrëmbim. Të pandehurit më heerët janë marrë vesh të kryejnë një vepër penale, e cila do të kualifikohet në mënyrë të drejtë si rrëmbim, në bashkë-veprim, në kundërshtim me nenet 159, paragrafi 2 dhe 23 të KPK-së, duke përmbushur si elementin material (*actus rei*) ashtu edhe elementin psikologjik (*dolus*) të një krimi të tillë. Në veçanti, të gjithë të pandehurit kanë kontribuar në aktivitetin kriminal, sepse, më 10 dhjetor 2005, rreth orës 00:30, në Prishtinë, lagjja Dardania, në bashkë-veprim, qëllimisht dhe në bazë të një marrëveshje të mëhershme, kanë rrëmbyer viktimën D Sh, e kanë fshehur atë në shtëpinë e Shahin SFISHTËS, në

rrugën Fitorja në Podujevë, deri sa e kanë liruar, më 13 dhjetor 2005 rreth orës 02:00, pasi që i ati i Gani SHALËS kishte paguar, në një rrugë të paasfaltuar afër fshatit Bradash, haraçin prej 230.000,00 EURO. Duke marrë parasysh rrethanën tanimë të dëshmuar që rrëmbimi është kryer nga rrëmbyesit si anëtarë të grupit dhe kërcënim për jetë ndaj të rrëmbyerit, dispozita relevante e aplikuar është Neni 159, Paragrafi 2, i KPK-së, e dënueshme me burgim prej një në dhjetë vite.

7. Caktimi i Dënimit

7.1. Dënimi për Bekim RASHITIN.

Për sa i përket dënimit të caktuar për të pandehurin Bekim RASHITI, Gjykata ka marrë parasysh rrethanat e përmendura në Nenin 64 të KPK-së dhe veçanërisht shkallën e lartë të përgjegjësisë penale, që del nga roli i tij i shquar dhe kryesor në rrëmbim. Ai ka qenë personi, së bashku me të pandehurin në arrati Arben SFISHTA, që ka ofruar udhëzime për të gjithë të pandehurit e tjerë dhe që ka mbledhur haraçin nga Gani SHALA.

I pandehuri kurrë nuk e pranoj përgjegjësinë penale në asnjë fazë të procedurës penale dhe asnjë herë nuk dha ndonjë shenjë të pendimit për krimin e kryer.

Në anën tjetër, Gjykata po ashtu ka marrë në konsideratë rrethanat që viktima D Sh, derisa është mbajtur me dhunë në shtëpinë e Shahin SFISHTËS, gjithmonë është trajtuar me sjellje të njerëzishme dhe nuk është keqtrajtuar në asnjë mënyrë. Atij i është ofruar ushqim dhe e gjithë ndihmesa tjetër thelbësore kryesore. Kjo dëshmohet përmes raportit të vizitës mjekësore të D Sh menjëherë pas lirimimit të tij nga Qendra Klinike Universitare e Prishtinës, datë 13 dhjetor 2005: “Anamneza: pacienti është sjell në Qendrën Emergjente i përcjell nga policia vendore dhe ndërkombëtare në mënyrë që t’i kontrollohet gjendja e tij shëndetësore. Në pranim ai e din se ku ndodhet, me vetëdije, i komunikueshëm, me të rrahura ritmike të zemrës, tinguj të pastër, frymëmarrje normale dhe gjendje stabile psiko-fizike. Ai ankohet vetëm për një dhembje të vogël në kyç të dorës që i dhëmbë pasi që ishte i prangosur për tre ditë. Personi ishte rrëmbyer dhe mbajtur në një dhomë të ftohtë dhe e mohon të jetë keqtrajtuar.”

Prandaj, duke marr parasysh Nenin 159, Paragrafi 2, i KPK-së, i cili dënon rrëmbimin e rëndë me burgim prej një deri në dhjetë vite dhe në përputhje me Nenin 38 të KPK-së, dënimi do të përcaktohet në mënyrë të paanshme me burgim prej pesë (5) vitesh.

Koha e kaluar në paraburgim nga i akuzuari do të përfshihet në kohëzgjatjen e dënimit.

7.2. Dënimi për Visar AHMETIN.

Për sa i takon të akuzuarit Visar AHMETI, Gjykata ka marrë në konsideratë të gjitha rrethanat e përmendura në Nenin 64 të KPK-së dhe në veçanti faktin që, pavarësisht nga roli i tij modest në mbarë në organizimin e tërësishëm të rrëmbimit, mbështetja e tij po ashtu ishte esenciale për të vazhduar me rrëmbimin, pasi që kishte ofruar për të marrë me veturë Bekim RASHITIN nga vendi ku haraçi do të paguhej dhe për të kontaktuar personin nga i cili ata kishin huazuar armën. Ai kishte vendosur t ‘i bashkohej bashkë-

kryerësve për një aktivitet shumë serioz kriminal dhe ai ishte qartazi krejtësisht i vetëdijshëm mbi pasojat e drejtpërdrejta të rrëmbimit të personave të dëmtuar dhe mbi rreziqet e ndërlidhura me një aktivitet të kriminal.

I pandehuri asnjëherë nuk kishte pranuar përgjegjësinë penale në asnjë fazë të procedurës penale dhe asnjëherë nuk kishte paraqitur asnjë shenjë të pendimit për veprën penale të kryer.

Prandaj, duke marrë parasysh Nenin 159, Paragrafin 2, të KPK-së, i cili dënon rrëmbimin e rëndë me burgim prej një deri në dhjetë vite dhe në përputhje me Nenin 38 të KPK-së, dënimi do të përcaktohet në mënyrë të paanshme me burgim prej tre (3) vitesh.

Koha e kaluar në paraburgim nga i akuzuari do të përfshihet në madhësinë e dënimit.

7.3. Dënimi për Valon VLLASËN.

Për sa i takon pozitës së të akuzuarit Valon VLLASA, Gjykata ka marrë në konsideratë të gjitha rrethanat e përmendura në Nenin 64 të KPK-së, me një referencë të veçantë mbështetjes së përgjithshme aktive dhënë gjatë gjithë kohës nga ana e të pandehurit për Bekim RASHITIN dhe bashkë kryerësit e tjerë.

I pandehuri asnjëherë nuk ka pranuar përgjegjësinë penale në asnjë fazë të procedurës penale dhe asnjëherë nuk kishte dhënë asnjë shenjë të pendimit për veprën penale të kryer.

Prandaj, duke marrë në konsideratë Nenin 159, Paragrafi 2, i KPK-së, që dënon rrëmbimin e rëndë me burgim prej një deri në dhjetë vite dhe në përputhje me Nenin 38 të KPK-së, dënimi duhet të përcaktohet në mënyrë të paanshme me burgim prej katër (4) vitesh.

Koha e kaluar në paraburgim nga i akuzuari do të përfshihet në madhësinë e dënimit.

7.4. Dënimi për V S.

Për sa i takon pozitës së të akuzuarit V S, Gjykata ka marrë parasysh se ai ishte i mitur në kohën e kryerjes së veprës penale. Gjykata po ashtu ka marrë në konsideratë që, duke qenë vëllai i vogël i bashkë-kryerësit Arben SFISHTA, ai ka mundur të jetë i ndikuar nga ky i fundit për të marrë pjesë në rrëmbim. Në anën tjetër, Gjykata po ashtu ka vlerësuar që V S ishte shtatëmbëdhjetë vjeç (gati i rritur) në kohën e ngjarjes dhe që ai kishte vendosur të përfshihej thellësisht në një krim shumë serioz siç është rrëmbimi për të cilin ai sigurisht e ka kuptuar seriozitetin, e posaçërisht pasi që ai ishte në kontakt të afërt me viktimën me që ishte roja e tij.

Gjykata ka marrë parasysh që sipas këtyre rrethanave dhe në Përputhje me Nenin 38, 48 (2) dhe (3), 159 (2) dhe 23 të KPK-së dhe Nenin 6 (5) të Kodit të Drejtësisë për të Mitur të Kosovës, pas leximit të rekomandimeve me shkrim të Shërbimit Sprovues, është e duhur për t' i dhënë të pandehurit një dënim me kusht prej dy (2) vitesh të burgimit për të mitur.

Në përputhje me Nenin 48 (2) të KPK-së, dënimi nuk do të ekzekutohet nëse personi i dënuar nuk kryen një tjetër vepër penale për një periudhë prej pesë (5) vitesh nga data që aktgjykimi bëhet i formës së prerë.

Duke marrë parasysh që i pandehuri kurrë nuk kishte pranuar përgjegjësinë penale në asnjë fazë të procedurës penale dhe asnjëherë nuk kishte paraqitur asnjë shenjë të pendimit për krimin e kryer, Gjykata ka vendosur që, në përputhje me Nenin 48 (3) të KPK-së, dënimi të ekzekutohet nëse, brenda një (1) viti nga data që aktgjykimi bëhet i formës së prerë, personi i dënuar nuk kompenson palët e dëmtuara (D Sh dhe Gani SHALËN) me shumën prej 200.000,00 EURO. Kjo shumë është rezultat i dëmit total të shkaktuar për palët e dëmtuara (230.000,00 EURO), duke zbritur dorëzantinë e konfiskuar të paguar nga Bekim RASHITI që po ashtu do të transferohet për palët e dëmtuara (30.000,00 EURO).

8. Kërkesa Pronësore

I akuzuari, në mënyrë kumulative dhe së bashku, duhet të kompensoj palët e dëmtuara (D Sh dhe Gani SHALËN), për dëmet e shkaktuara të cilat janë përcaktuar, pas kërkesës, prej 230.000,00 EURO.

Pala e dëmtuar Gani SHALA ka konfirmuar në Gjykatë që shuma totale përfundimtare e të hollave të paguar si haraç për kryerësit e veprës penale ishte 230.000,00 EURO, para të cilat ai ka qenë në gjendje të mbledhë duke i huazuar ato nga miqtë e tij. Është momenti për të përmendur se shuma e përmendur e të hollave ishte mbledhur në praninë e policisë.

Me sa vijon është një fragment nga procesverbali i dëshmisë së Gani SHALËS:

Vahide Braja: Unë kam një pyetje, e cila është, duke marrë parasysh faktin që policia ishin të informuar që personi ishte në rrezik dhe nevojiteshin të hollat, a i kishin gjetur policia ndonjë shumë të të hollave Ganiut? Është e çuditshme.

Gani Shala: Unë dhashë deklaratën time dhe nuk kam kërkuar të holla nga policia. Miqtë e mi më gjetën të hollat dhe të gjitha ato që më ishin dhënë, më ishin dhënë në prani të policisë.

Francesco Florit: Dy pyetje që mund të tingëllojnë të çuditshme por më duhet t' i bëj. A ju janë kthyer paratë?

Gani Shala: Jo.

Francesco Florit: A u ke kthyer miqve të tu paratë që kishe marrë nga ata?

Gani Shala: Po, kam shitur tokën dhe kam dokumente për të vërtetuar këtë dhe kredinë, paratë e huazuara nga bankat dhe unë ende jam duke paguar ato këste mujore.

Kryetari i Trupit Gjykses: Po Z. Shala, ju duhet të përmendni në mënyrë të veçantë sa para nga haraçi ishin para të huazuara nga miqtë dhe sa ishin tuajat?

Gani Shala: Unë pagova 230,000 € dhe e tëra kjo shumë ishte mbledhur dhe grumbulluar nga miqtë e mi. Në atë moment nuk kam pasur burime financiare vetëm rreth 5 apo 6,000 nën diskonim timin. Para rrëmbimit i isha nënshtruar një intervenimi kirurgjik dhe kisha blerë një veturë.

9. Konfiskimi i dorëzarisë të paguar nga Bekim RASHITI.

Në përputhje me Nenin 277 (4) të KPPK-së, dorëzania e vendosur mbi personin e dënuar prej 30.000,00 EURO, pas vendimit të Gjyqtarit të Procedurës Paraprake datë 14 qershor 2006, nëpërmjet kësaj anulohet.

Në përputhje me Nenin 494 të KPPK-së shuma e njëjtë e të hollave prej 30.000,00 EURO konfiskohet dhe mbartet te palët e dëmtuara (D Sh dhe Gani SHALA) si kompensim i pjesshëm i dëmeve.

10. Kostot e procedurës penale

Në përputhje me Nenet 102, Paragrafët 1 dhe 3, dhe 391, paragrafi 1 pika 6), e KPPK-së, të gjithë të pandehurit janë bashkërisht dhe veçmas përgjegjës për kostot e procedurës penale dhe duhet të rimbursojnë ato sipas listës së kostove e cila do të përcaktohet në kohën e duhur.

Në përputhje me nenin 100, paragrafi 2, i KPPK-së, pasi që të dhënat mbi shumën e kostove mungojnë, do të merret një vendim i veçantë mbi shumën e kostove.

27 maj 2009

Kryetari i Trupit Gjykses
Andrea CRUCIANI

Anëtar i Panelit
Francesco FLORIT

Anëtar i Panelit
Ferid BISLIMI

Procesmbajtësja
Jacqueline Ryan

Këshillë Juridike

Në përputhje me nenin 400 (1) të KPPK-së, një ankesë mund të bëhet e ditur brenda 8 ditëve nga shpallja e këtij vendimi dhe në përputhje me nenin 398(1) të KPPK-së, ankesa duhet të dorëzohet në këtë Gjykatë brenda 15 ditësh nga data që kopja e aktgjykimit i është dorëzuar palëve.